



2016

RAPORT VJETOR



K.R.U „HIDROREGJIONI JUGOR” SH.A

Rr. Wesley Clark p.n. Prizren 20000

www.hr-jugor.com

1.Përmbajtja

Zonat e përgjegjësisë së K.R.U. „HIDROREGJIONI JUGOR“

4

2. RAPORTI I KRYESUESIT TË BORDIT TË DREJTORËVE

5

2.1	Aktivitetet dhe performancat e ndërmarrjes	5
2.1.1	Aktivitetet e ndërmarrjes gjatë vitit	5
2.1.2	Pasqyrat e performancave operative dhe financiare	6
2.1.3	Ngjarjet te cilat ndikojn ne te ardhmen e ndermarrjes	10
2.1.4	Pasqyrat e te priturave per vitin e ardhshem	10
2.2	Informacionet lidhur me kapitalin dhe dividendat	11
2.2.1	Kredit e rendesishme te nenshkuara apo paguara gjate vitit	11
2.2.2	Investimet gjate vitit 2016	11
2.2.3	Dividentat e paguara gjate vitit 2016	13
2.3	Te dhenat per drejtot jo- ekzekutiv	14
2.3.1	Emrat e drejtove te bordit te drejtove	14
2.3.2	Numri i takimeve te bordit te drejtove	15
2.3.3	Numri i takimeve te komiteteve te bordit	15
2.3.4	Informacionet e tjera te bordit gjate vitit	16


3 RAPORTI I ZYRTARIT KRYESOR EKZEKUTIV

28

3.1	Ngjarjet kryesore te vitit	28
3.1.1	Aktivitetet nga Shërbimi Teknik	28
3.1.2	Aktivitetet e Shërbimit Teknik për eliminimin e humbjeve teknike	38
3.1.3	Planifikimi I investimeve emergjente	38
3.1.4	Prodhimi I ujit - m3	38
3.1.5	Mirëmbajtja e rrjetit- sanimi I defekteve	39
3.1.6	Zyra për planifikim dhe zhvillim	39
3.1.7	Servisimi I ujëmatësave	41
3.1.8	Analizat Fiziko-Kimike dhe Bakteriologjike	42
3.1.9	Raport I Njësive Punuese	46
3.2.1	Aktivitetet nga Shërbimi Rajonal Për Konsumatorë	50
3.2.2	Raport I ekipes së Kontrollës dhe shkyçjes	51
3.2.3	Raport I ankesave	51
3.2.4	Raport I mediave	52
3.3.1	Aktivitetet e Departamentit Administrativ	55
3.3.2	Personeli	57
3.3.3	Kualifikimi i punëtorëve	58
3.3.4	Numri I punëtorëve sipas nacionaliteteve	58

3.4.1	Raporti nga Shërbimi financiar	66
3.4.1.1	Pasqyra e performances-Janar-Dhjetor 2016	68
3.4.1.2	Progresi me Planin e Biznesit	70
3.5.2	Raport I aktiviteteve te prokurimit	71
3.5.3	Shpenzimet kapitale te projekteve gjate vitit 2016	74
3.6	Prespektiva per vitin e ardhshem	75
3.6.1	Qellimet dhe objektivat strategjike	75
3.6.2	Objektivat kryesore te KRU	75
3.6.3	Treguesit kryesor te performances 2017-2018	76
4	RREZIQET E TË ARDHMES	76
5	PASQYRAT FINANCIARE	77
6	INVESTIMET	89
6.1	Plani I investimeve kapitale	89
6.1.1	Plani I investimeve kapitale- ujesjelles	90
6.1.2	Plani I investimeve kapitale- kanalizim	91
7	RAPORT I AUDITORIT	92
7.1	Raport i auditorit te brendshem	92
8	ORGANOGRAMI	95

ZONAT E PËRGJEGJËSISË SË K.R.U „HIDROREGJIONI JUGOR“ SH.A



2. RAPORTI I KRYESUESIT TË BORDIT TË DREJTORËVE

2.1 Aktivitetet dhe performanca e ndërmarrjes

2.1.1 Aktivitetet e ndërmarrjes gjatë vitit

FURNIZIMI

Furnizimi me uje te pijes ne nivel regjional ka qene i rregullt, nepër të gjitha njësitë punuese kemi arritur të kemi gjendje stabile të furnizimit me ujë. Kompania është angazhuar dhe ka arritur që në Vitit 2016 të furnizojë konsumatorët me ujë të pijes 24 orë në përjashtim të zonave të larta të cilat furnizohen me sistem të pompimit ku edhe kemi reduktime (Kryesisht te lagja Dardanisë, pjesa e Bazhdarhanës dhe në rrugën e Janinës).

Sa i perket pjeses së Bazhdarhanës kryesisht banesave kolektive, kemi bërë një ndryshim teknik të furnizimit përmes valvulave të sistemit dhe momentalisht kjo pjese ka furnizim 24 orë me ujë të pijes. Duhet cekur se ky ndryshim teknik është ende në provë dhe për çdo ndryshim të konsumit si shkak i temperaturave të larta, munde të kemi reduktime deri sa të finalizojmë projektin e planifikuar për ndarjen e furnizimit në lagjen Dardania. Në njësitë tjera si në Malishevë, Suharekë dhe Dragash nuk ka probleme me furnizim më ujë të pijes dhe duke u bazuar në raportet e njesive operuese kemi patur furnizim të rregullët me ujë të pijes.

UJI I PRODHUAR

Për Vitit 2016 në nivel regjional janë raportuar prodhim të ujit **17,371,213.00 m³**, krahasuar nga Vitit 2015 kemi një rritje të prodhimit të ujit të pijes prej **62,524.00 m³**. Jane duke vazhduar aktivitetet për të mbajtur gjendjen stabile të furnizimit me ujë.

UJI I PAFATURUAR

UPF vazhdon të mbetet një sfide kryesore e të gjitha shërbimeve të kompanisë, ku në bashkëpunim me të gjitha shërbimet si dhe duke ju falemenderuar donatoreve të huaj dhe institucioneve vendore kemi planifikuar aktivitete kryesisht në zvogelimin e UPF-se.

Kompania në nivel regjional ka shtuar aktivitetet kryesore për zvogelimin e UPF-së që nënkupton parandalimin e keqpërdorimeve dhe sanimin me kohë të defekteve në terësi.

Shërbimi Teknik me të gjithë sektoret e tij është duke evidentuar të gjitha rrjedhjet dhe me të gjitha kapacitetet është duke u përpjekur për sanimin e defekteve sa më shpejtë.

Kompania është duke i vazhduar aktivitetet për zvogelimin e UPF-së dhe rritjen e kapaciteteve të ujit të pijes.

Raportet tregojne që UPF në nivel regjional për Vitit 2016 është **57,71 ose 0.12%** me zvoglim të UPF nga Vitit 2015.

2.1.2 Pasqyrat e performancës operative dhe financiare në krahasim me vitin paraprak dhe planin e vitit aktual

PRODHIMI - m3								
NJËSIA PUNUESE	JANAR-DHJETOR 2014		JANAR-DHJETOR 2015		JANAR-DHJETOR 2016		JAN-DHJE 2015 (PB)	
	l/sec	m3	l/sec	m3	l/sec	m3	l/sec	m3
PRIZREN	430.0	13,562,010	442.9	13,966,192	429.1	13,533,249	412.8	13,018,880
SUHAREKË	67.8	2,137,527	62.8	1,980,778	65.1	2,052,541	69.1	2,178,000
MALISHEVË	42.6	1,344,602	42.6	1,342,594	43.5	1,373,065	62.8	1,980,000
DRAGASH	13.9	438,560	12.5	394,480	13.0	410,758	12.9	405,900
TOTAL	554.4	17,482,699	560.8	17,684,044	550.8	17,369,613	557.5	17,582,780
NDRYSHIMI l/sec			6.38	201,345	-9.97	(314,431)	-6.76	(213,167)
NDRYSHIMI %				1.15%		-1.78%		-1.21%

NUMRI I FATURAVE TË LËSHUARA					
No.	Të dhënat	JANAR-DHJETOR 2014	JANAR-DHJETOR 2015	JANAR-DHJETOR 2016	JANAR-DHJETOR 2016 (PB)
1	Shtëpiak	35,710	36,878	38,854	37,377
2	Ndryshimi		1,168	1,976	1,477
3	Ndryshi. %		3.06	5.16	3.86
4	Kome.-Indu.	4,630	5,067	5,258	5,624
5	Ndryshimi		437	191	(366)
6	Ndryshi. %		8.44	3.67	(7.04)
7	Institucional	625	607	521	610
8	Ndryshimi		(18)	(86)	(89)
9	Ndryshi. %		(2.97)	(14.19)	(14.69)
10	TOTAL	40,965	42,552	44,633	43,611
11	Ndryshimi		1,587	2,081	1,022
12	Ndryshi. %		3.61%	4.72%	2.32%

FATURIMI - m3					
No.	Të dhënat	JANAR-DHJETOR 2014	JANAR-DHJETOR 2015	JANAR-DHJETOR 2016	JANAR-DHJETOR 2015 (PB)
1	Shtëpiak	5,942,640	6,245,390	6,174,450	6,494,580
2	Ndryshimi		302,750	(70,940)	(320,130)
3	Ndry. %		5.1	(1.1)	(5.1)
4	Kome.-Indu.	487,779	519,597	541,990	605,408
5	Ndryshimi		31,818		(63,418)
6	Ndry. %		6.5		(12.2)
7	Institucional	749,562	690,234	625,986	709,867
8	Ndryshimi		(59,328)		(83,881)
9	Ndry. %		(7.9)		(12.2)
10	TOTAL	7,179,981	7,455,221	7,342,426	7,809,855
11	Ndryshimi		275,240	(112,795)	(467,429)
12	Ndry. %		3.8	(1.5)	(6.3)

FATURIMI - €					
No.	Të dhënat	JANAR-DHJETOR 2014	JANAR-DHJETOR 2015	JANAR-DHJETOR 2016	JANAR-DHJETOR 2015 (PB)
1	Faturimi-€	3,958,232.29	4,160,752.77	4,139,427.84	4,528,352.63
2	Total- Shte.	2,795,252.60	2,998,067.84	2,999,760.72	3,241,975.36
3	Ndryshimi		202,815.24	1,692.88	(242,214.64)
4	Ndry. %		7.3%	0.1%	-8.1%
5	Total- kome.	648,687.36	693,328.00	702,222.65	770,213.33
6	Ndryshimi		44,640.64	8,894.65	(67,990.68)
7	Ndry. %		6.9%	1.3%	-9.8%
8	Total-Inst.	514,292.33	469,356.93	437,444.47	516,163.94
9	Ndryshimi		(44,935.40)	(31,912.46)	(78,719.47)
10	Ndry. %		-8.7%	-6.8%	-16.8%
11	Te tjera	109,390.54	99,388.39	77,947.93	104,832.20
12	Total	4,067,622.83	4,260,141.16	4,217,375.77	4,633,184.83
13	Ndryshimi		192,518.33	(42,765.39)	(415,809.06)
14	Ndry. %		4.7%	-1.0%	-9.8%

SHPENZIMET					
No.	Të dhënat	JANAR-DHJETOR 2014	JANAR-DHJETOR 2015	JANAR-DHJETOR 2016	JANAR-DHJETOR 2016 (PB)
1	Total Shpenzimet Operative	3,069,745.28	3,168,617.00	3,273,224.80	3,118,297.00
2	Pagat	1,728,729.68	1,769,145.00	1,860,957.71	1,792,830.00
3	Rryma elektrike	798,223.88	872,795.00	854,176.83	801,698.00
4	Shpen. e derivateve	97,125.75	82,704.00	65,895.33	85,244.00
5	Mirem. dhe riparimet	261,524.00	181,218.00	241,568.51	174,770.00
6	Kemikaliet	7,029.00	12,142.00	12,607.13	13,142.00
7	Shpenzimet e tjera	177,112.97	250,613.00	238,019.29	250,613.00
8	Ndryshimi		98,872	104,608	154,928
9	Ndryshimi ne %	-	3.2%	3.3%	4.9%

NUMRI I PUNËTORËVE

JANAR - DHJETOR 2016

KRU „HIDROREGJIONI JUGOR " SH.A - PRIZREN

Nr.	MUAJI	PRIZREN	SUHAREKË	DRAGASH	MALISHEVË	HIDROREGJIONI	BORDI	TOTAL
1	JANAR	220	37	19	32	308	6	314
2	SHKURT	223	37	19	32	311	6	317
3	MARS	229	37	19	32	317	6	323
4	PRILL	227	38	16	32	313	6	319
5	MAJ	230	37	16	33	316	6	322
6	QERSH	231	38	16	33	318	6	324
7	KORRIK	231	38	16	34	319	6	325
8	GUSHT	229	38	16	34	317	6	323
9	SHTAT	230	37	16	34	317	6	323
10	TETOR	227	37	16	35	315	6	321
11	NËNTOR	229	36	16	34	315	6	321
12	DHJETOR	231	37	16	35	319	6	325

ARKËTIMI -€
REALIZIMI I CAQEVE - JANAR-DHJETOR - 2016
K.R.U „HIDROREGJIONI JUGOR“ SH.A - PRIZREN

No.	Të dhënat	JANAR-DHJETOR 2014	JANAR-DHJETOR 2015	JANAR-DHJETOR 2016	JANAR-DHJETOR 2015 (PB)
1	Total- Shtëpiak	1,996,699.73	2,136,660.93	2,643,393.02	2,305,278.28
2	Ndryshimi		139,961.20	506,732.09	338,114.74
3	Ndry. %		7.0%	23.7%	15.8%
4	Total-Komercial-Industrial	364,088.30	438,552.45	450,873.50	494,034.18
5	Ndryshimi		74,464.15	12,321.05	(43,160.68)
6	Ndry. %		20.5%	2.8%	-9.8%
7	Total Institucional	626,650.83	444,844.97	515,476.03	497,583.56
8	Ndryshimi		(181,805.86)	70,631.06	17,892.47
9	Ndry. %		-29.0%	15.9%	4.0%
10	Total - ujë	2,987,438.86	3,020,058.35	3,609,742.55	3,296,896.02
11	Ndryshimi		32,619.49	589,684.20	312,846.53
12	Ndry. %		1.1%	19.5%	10.4%
13	Te tjera	88,205.07	51,037.83	42,806.26	61,751.60
14	Ndryshimi		(37,167.24)	(8,231.57)	(18,945.34)
15	Ndry. %		-42.1%	-16.1%	-37.1%
16	TOTAL	3,075,643.93	3,071,096.18	3,652,548.81	3,358,647.62
17	Ndryshimi		(4,547.75)	581,452.63	293,901.19
18	Ndry. %		-0.1%	18.9%	9.6%

Treguesit e Performancës		JANAR-DHJETOR 2014	JANAR-DHJETOR 2015	JANAR-DHJETOR 2016	JANAR-DHJETOR 2015(PB)
Uje i faturuar-si perqindje	%	41.07	42.16	42.27	43.47
Uje i pafaturuar-si perqindje	%	58.93	57.84	57.73	56.53
Norma e arketimit - e pergjithshme	%	75.47	74.15	87.20	72.86
Norma e arketimit - Amviserite	%	71.43	72.96	88.12	71.11
Norma e arketimit -Komercial-Industrial	%	56.13	63.25	64.21	64.14
Norma e arketimit -Institucional	%	121.85	62.98	117.84	96.40
Norma e Mbulimit operativ	numer	1.00	0.95	1.12	1.07
Staf per 1000 konsumatore	numer	7.07	7.16	7.17	7.20

2.1.3 Ngjarjet të cilët ndikojnë në të ardhmen e ndërmarrjes

Gjatë tri viteve të ardhshme Kompania mund t ballafaqohet me rritje të çmimit të energjise elektrike si dhe me rënie të vazhdueshme të burimeve të ujit të pijes që si pasojë mund të sjellë edhe deri tek rritja e reduktimeve të furnizimit.

Rritja e konsumatoreve me raste sociale, moszhvillimi ekonomik mund të ndikojë në rënie të arketimit.

Kompania ka marrë masa konkrete në gjetjen e burimeve alternativ që do të rritë sigurinë e kompanisë në sigurimin e furnizimit me ujë të pijes edhe në raste emergjente.

Këto masa janë diskutuar edhe me institucionet tjera relevante si dhe me donatore të ndryshëm, nga të cilët edhe presim përkrahje financiare.

2.1.4 Pasqyra e të priturve për vitin e ardhshëm

Si qellime kryesore të KRU “Hidroregjioni Jugor” Sh.A. janë:

- Kontinuiteti i vazhdueshëm i prodhimit të ujit të pijshëm,
- Kontrolla e kualitetit të ujit të pijshëm të jetë në pajtim me instruksionet e lëshuara ngarregullorret në fuqi.
- Rritja e shkallës së inkasimit si dhe zvogëlimi i ujit të pafaturuar
- Rritja e shkallës së efikasitetit të punëtorëve.

Performancat e pritura për vitin 2016

Treguesit e Performancës		2016	2017	2018
Uje i faturuar-si perqindje	%	43.47	48.43	51.10
Uje i pafaturuar-si perqindje	%	56.53	51.57	48.90
Norma e arketimit - e pergjithshme	%	72.86	75.66	80.22
Norma e arketimit - Amviserite	%	71.12	73.86	79.05
Norma e arketimit -Komerical-Industrial	%	64.14	66.61	68.97
Norma e arketimit -Institucional	%	96.92	100.65	104.22
Norma e Mbulimit operativ	numer	1.07	1.14	1.25
Staf per 1000 konsumatore	numer	7.20	6.78	6.59

2.2 Informacione lidhur me kapitalin dhe dividendet

Vlera e kapitalit eshte rritur per + 21.653,00. Divident nuk eshte raportuar

2.2.1 Kredit e rëndësishme të nënshkuara apo paguara gjatë vitit

Gjatë vitit 2016 nuk ka patur kredi të rëndësishme të nënshkuar nga kompania.

2.2.2 Investimet e rëndësishme gjatë vitit 2016

Investimet nga Qeveria gjermane - KfW

NR.	Projekti	Investuesi	Emertimi dhe Numri I Kontrates	Punemarresi/ Furnizuesi/ Numri Fiskal	Arsyeshmeria e projektit	Vlera e Kontrates ne EURO
1	Largimi I Ujerave te Zeza në Kosovën Jugperendimore	KfW	Largimi I Ujerave te Zeza në Kosovën Jugperendimore (BMZ 2010 65 663)	PASSAVANT AQUALIA	Traltimi I Ujerave te Zeza, Mbrojtja e burimeve nentokesore te ujit dhe permiresimi I shendetit te popullates (VIJIM)	12,000,000.00 Ne vijim
2	Eficienca ne energjine elektrike	KfW		/	Ndrimi dhe Ridemninsionimi I gypave kryesor transportues nga 40 burmiet deri te rrjeti shperndares ne Prizren, si rezultat I rritjes se kapacitetve te ujit te lokacioni 40 burimet, me crast do te kemi furnizim 24 oresh afatgjate per gjithe qytetin e Prizrenit me fshatra, si dhe kursim te energjise elektrike. (VIJIM)	2,500,000.00 Ende ska filluar
3	TOTAL					14,500,000.00 €

Investimet nga Qeveria Zvicerane- DORSCH-CDI

NR.	Projekti	Investuesi	Emertimi dhe Numri I Kontrates	Punemarresi/ Furnizuesi/ Numri Fiskal	Arsyeshmeria e projektit	Vlera e Kontrates ne EURO
1	Programi mbi rehabilitimin dhe sistemin e ri te UJESJELLSAVE TE fshatrave te cilat nuk jane nen menaxhim te HRJ	QEVERIA ZVICERABE - (DORSCH-CDI)		Disa kontraktues...	Faza I Rehabilitimi I ssitemeve egzistuese qe nuk jane nen menaxhim te HRJ Faza II ndertimi isistemve te reja te ujesjellesit ne Komunat ku menaxhon HRJ (VIJIM)	Vlera e realizuar; 238.802.02 € VIJIM
3	TOTAL					

Investimet nga MZHE - MMPH,MF

NR.	Projekti	Investuesi	Emertimi dhe Numri I Kontrates	Punemarresi/ Furnizuesi/ Numri Fiskal	Arsyeshmeria e projektit	Vlera e Kontrates ne EURO
1	Largimi I Ujerave te Zeza në Kosovën Jugperendimore	MZHE	Largimi I Ujerave te Zeza në Kosovën Jugperendimore (BMZ 2010 65 663)	PASSAVANT + AQUALIA	Traktimi I Ujerave te Zeza, Mbrojtja e burimeve nentokesore te ujit dhe permiresimi I shendetit te popullates (VIJIM)	5,000,000.00 VIJIM
2	Rehabilitim I kaptazhes neGjonaj te Hasit Pz	MMPH	Reha. I Kaptazhes ne fsh. Gjonaj-Marrveshja Nr: 3963/15	ALBING - Fat Nr. 59/16, 62/16	Permiresimi I furnizimti me uje te pijes	39,420.05
4	TOTAL					39,420.05 €

Investimet nga Kuvendet Komunale

NR.	Projekti	Investuesi	Emertimi dhe Numri I Kontrates	Punemarresi/ Furnizuesi/ Numri Fiskal	Arsyeshmeria e projektit	Vlera e Kontrates ne EURO
1	Largimi I Ujerave te Zeza në Kosovën Jugperendimore	Komuna e Prizrenit	Largimi I Ujerave te Zeza në Kosovën Jugperendimore (BMZ 2010 65 663)	PASSAVANT + AQUALIA	Traktimi I Ujerave te Zeza, Mbrojtja e burimeve nentokesore te ujit dhe permiresimi I shendetit te popullates (VIJIM)	6,000,000.00 VIJIM
2	Hapja e puseve piezometrike dhe eksploatuese per nevojat e KRU"HIDROREGJIONI"	KK-Malishevë	HJ-16*014-521	BURIMI	Shtimi I sasise se ujit- Permiresimi I furnizimit	75,957.85
3	Shtimi I sasis se ujit permes shpimit te puseve ne fshatin Senik Ma	KK-Malishevë	HJ- 15-004-111	XERXA	Shtimi I sasise se ujit- Permiresimi I furnizimit	2,770.40
4	Hapja e puseve piezometrike dhe eksploatuese per nevojat e KRU"HIDROREGJIONI"	KK-Malishevë	HJ-16-012-521	BURIMI	Shtimi I sasise se ujit- Permiresimi I furnizimit	47,008.04
5	Shtimi I sasis se ujit permes shpimit te puseve ne fshatin Senik Ma	KK-Malishevë	HJ-15-004-111	ENDRITI	Shtimi I sasise se ujit- Permiresimi I furnizimit	3,671.08
6	Zavendsim rrjetit ujsjellsit ne Samadraxh Sr	KK-Suharekë	624-116-038-136	EMSA	Permiresimi I furnizimit	7,000.00
7	Shtimi I kapaciteteve te ujit ne qytetin e Prizrenit	KK-Prizren	Nr. I protokoli; 091/04.02.2016	Xerxa, Gashi Ing.	Shtimi I kapaciteteve te ujit ne qytetin e Prizrenit	928,381.88
8	TOTAL					1.064.789.25 €

Investimet nga KRU „HIDROREGJIONI JUGOR” SH.A

NR.	Projekti	Investuesi	Emertimi dhe Numri I Kontrates	Punemarresi/ Furnizuesi/ Numri Fiskal	Arsyeshmeria e projektit	Vlera e Kontrates ne EURO
1	Hapjapusevepiezometrike dhe eksploatuese per nevojat e KRU "HIDROREGJIONI"- Senik- MA	KRU	HJ-16-014-521	BURIMI	Shtimi I sasise se ujit- Permiresimi I furnizimit	79,058.15
2	Riparime dhe mirmbajtje ,rrafshim I terenit per hapjene puseve,gropim tereneiper hapjen e puseve Samadrhx Sr	KRU	HJ-16-012-521	BURIMI	Permiresimi I sherbimeve	10,880.60
3	Shtimi I sasis se ujit permes shpimit te puseve ne fshatin Senik Ma	KRU	HJ-15-004-111	ENDRITI	Shtimi I sasise se ujit- Permiresimi I furnizimit	3,820.92
4	Hulumtimi dhe shtimi I ujit te pijes ne fshatin Gjonaj	KRU	HJ-16-012-521	BURIMI	Shtimi I sasise se ujit- Permiresimi I furnizimit	12,174.52
5	Hulumtimi dhe shtimi I ujit te pijes ne fshatin Gjonaj	KRU	HJ-16-012-522	BURIMI	Shtimi I sasise se ujit- Permiresimi I furnizimit	14,178.92
6	Furnizim me mater. ndert.perkru"hidroregjioni jugor"pz	KRU	HJ- 16-008-147	INTERTRANS	Rinovimi I objektit administrativ	904.51
7	Furnizim me dyer dritare kru"hidroregjioni"	KRU	HJ-16-010-147	TAHA	Rinovimi I objektit administrativ	660.00
8	Renovimi zyreve qendrore pz		HJ-16-014-547	MBG	Rinovimi I objektit administrativ	9,545.54
9	Furnizim me pompa-Baje- Malishevë	KRU	HJ-16-004-121	HITERM	Permiresimi I furnizimit me uje te pijes	1,954.14
10	Furnizim paisje mirembajtjes	KRU	2406216-10	Moni	Mirembajtje	249.84
11	Furnizim paisje mirembajtjes/ kontenier	KRU	2406216-10	Moni + KFOR	Mirembajtje	739.54
12	Pajisje per Zyre	KRU	Fatura te ndryshme	Furnitor te ndryshem	Aktivitet biznesi	3,057.17
13	Pajisje per IT	KRU	Fatura te ndryshme	Furnitor te ndryshem	Aktivitet biznesi	7,826.83
18	TOTAL					145,050.68 €

2.2.3 Dividentet e paguara gjatë vitit 2016

Kompania nuk ka patur dividende të paguara gjatë vitit 2016

2.3 Të dhënat për drejtor jo-ekzekutiv

2.3.1 Emrat e drejtorëve të bordit të drjetorëve

Rexhep Manxhuka

Kryesues i Bordit

Mob.: 045 / 223 563

044 / 163 120

e-mail: rexhep-manxhuka@hotmail.com

Ridvan Hoxha

Anëtar i Bordit

Mob.: 049/ 560 007

e-mail: rhoxha7@hotmail.com

Alban Zulfaj

Anëtar i Bordit

Mob.: 044 / 290 047

049 / 290 047

e-mail: alban_zulfaj@hotmail.com

Ylber Kuqi

Anëtar i Bordit

Mob.: 044 / 303 372

e-mail: ylber.kuqi@rks-gov.net / belkuqi@hotmail.com

Ramadan Abazi

Anëtar i Bordit

Mob.: 044 256 905

e-mail: r-abazi@hotmail.com

Reshit Makica

Anëtar i Bordit

Mob.: 044 / 184 528

e-mail: reshitmakica@hotmail.com

Besim Baraliu

Anëtar i Bordit

(Kryeshef Ekzekutiv)

Tel.&Fax.: 029 / 244 150 Mob.: 045 / 322 131

e-mail: sh.a-hidroregjionijugor-prizren@hotmail.com

2.3.2 Numri i takimeve të bordit gjatë vitit

MBLEDHJET E BORDIT TË DREJTORËVE K.R.U. „HIDROREGJIONI JUGOR” SH.A- PRIZREN

NR.	DATA	VENDI	VËREJTJE
1	29.01.2016	Prizren	
2	29.02.2016	Prizren	
3	29.03.2016	Prizren	
4	29.04.2016	Prizren	
5	30.05.2016		
6	17.06.2016	Prizren	Mbledhja e Pergjithshme vjetore me Aksionarin
7	28.06.2016	Prizren	
8	29.07.2016	Prizren	
9	30.08.2016	Prizren	
10	29.09.2016	Prizren	
11	28.10.2016	Prizren	
12	25.11.2016	Prizren	
13	23.12.2016		

2.3.3 Numri i takimeve të komiteteve të bordit gjatë vitit

MBLEDHJET E KOMISIONIT TË AUDITIMIT K.R.U. „HIDROREGJIONI JUGOR” SH.A- PRIZREN

NR.	DATA	VENDI	VËREJTJE
1	22.01.2016	Prizren	
2	18.02.2016	Prizren	
3	21.03.2016	Prizren	
4	28.04.2016	Prizren	
5	14.05.2016	Prizren	
6	23.06.2016	Prizren	
7	22.07.2016	Prizren	
8	24.08.2016	Prizren	
9	23.09.2016	Prizren	
10	26.10.2016	Prizren	
11	23.11.2016	Prizren	
12	20.12.2016	Prizren	

**MBLEDHJET E KOMITETIT TË FINANCAVE
K.R.U. „HIDROREGJIONI JUGOR” SH.A- PRIZREN**

NR.	DATA	VENDI	VËREJTJE
1	04.02.2016	Prizren	
2	29.03.2016	Prizren	
3	23.11.2016	Prizren	

**MBLEDHJET E KOMITETIT PËR HULUMTIME DHE TEKNOLOGJI
K.R.U. „HIDROREGJIONI JUGOR” SH.A- PRIZREN**

NR.	DATA	VENDI	VËREJTJE
1			

**MBLEDHJET E KOMITETIT PËR STAF DHE SHPERBLIME
K.R.U. „HIDROREGJIONI JUGOR” SH.A- PRIZREN**

NR.	DATA	VENDI	VËREJTJE
1	04.03.2016	Prizren	
2	01.06.2016	Prizren	
3	12.07.2016	Prizren	
4.	23.12.2016	Prizren	

**MBLEDHJET E KOMITETIT PËR DEFINIMIN E PRONËSISË
K.R.U. „HIDROREGJIONI JUGOR” SH.A- PRIZREN**

NR.	DATA	VENDI	VËREJTJE
1	11.03.2016	Prizren	

2.3.4 Informacione të tjera të bordit gjatë vitit

KUR Hidroregjioni Jugor udhëhiqet nga Bordi i drejtorëve të emëruar nga Qeveria e Republikës së Kosovës me vendimin Nr.11/56 të datës 30.10.2015. Bordi përbëhet nga 6 drejtorë. Komisioni i auditimit përbëhet nga 3 anëtarë.

Gjatë vitit 2016 Bordi i Drejtorëve ka mbajtur 13 takime të rregullta mujore, sipas procesverbaleve takimet e Bordit janë mbajtur me këto data: 29.01.2016; 29.02.2016; 29.03.2016; 29.04.2016; 30.05.2016; 17.06.2016; 28.06.2016; 29.07.2016; 30.08.2016; 29.09.2016; 28.10.2016; 25.11.2016; 23.12.2016.

Në këto takime angazhimet e bordit kanë të bëjnë me:

- Miratimin e raportit vjetor për vitin 2015
- Aprovimi i Revidimit të Plan-Biznesit për vitin 2016-2018
- Aprovimi i Plan Biznesit për vitin 2017-2019
- Raportet e Zyrtarit të auditimit të brendshëm.
- Është mbajtur Mbledhja së Përgjithshme Vjetore me Aksionarin në K.R.U. "Hidroregjioni Jugor" Sh.A Prizren (për vitin 2015).

- Bordi i Drejtorëve në takimin e mbajtur me 29.01.2016 në përputhje me nenin 31(31.2) të Ligjit për Ndërmarrjet Publike Nr.03/L-087 për raportet tremujore dhe nenin 18 Ligji Nr. 04/L-111 Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, Bordi i Drejtorëve i K.R.U "Hidroregjioni Jugor" Sh.A. Aprovoj-miratoj Raportin Operativ dhe Financiar për tre mujorin e katërt 2015 njëzëri.
- Bordi i Drejtorëve në takimin e mbajtur me 29.02.2016, në bazë të raportit njoftues të Komisionit të Auditimit, mori këto vendime: Bordi i Drejtorëve me qëllim të rritjes së efikasitetit dhe performancës së kompanisë merr vendim që nga data 01.03.2016, pagat e të gjithë punëtorëve të KRU "Hidroregjioni Jugor" SH.A Prizren, pagat të paguhen në bazë të % së mbulimit operativ me arsyetimin se ky vendim mirret për arsye të rritjes së efikasitetit të inkasimit, uljes së shpenzimeve dhe të gjithë faktoreve tjerë që ndikojnë në rritje të performancës së kompanisë.
 - Bordi i Drejtorëve duke u bazuar në gjendjen jo të mirë financiare të kompanisë mori këtë vendim: Bordi i Drejtorëve merr vendim që nga data 01.03.2016 praktikantet që vijnë për punë praktike në KRU "Hidroregjioni Jugor" sh.a Prizren të mos paguhen. Vërejtje: Përjashtohen ata praktikantë që janë tani me kontratë deri në skadimin e kontratës.
 - Bordi i Drejtorëve bazuar në kërkesën e Bordit të Drejtorëve për kompenzimin e komiteteve të përkohshme me qëllim të funksionimit sa më të mirë të kompanisë dhe në bazë të kompetencave që ka mori këtë vendim: Bordi i Drejtorëve merr vendim që anëtarët e Komiteteve të Bordit të Drejtorëve për takimet e mbajtura në Kompani të paguhen (për një takim në muaj) me mëditje sipas tarifave të përcaktuara me Vendim të Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 01/119 të datës 13.03.2013.
 - Bordi i Drejtorëve aprovoi konkluzionin e Komisionit të Auditimit ku në bazë të gjeturave në Raportin e Auditimit të Brendshëm, njësia punuese e Dragashit ka punëtor më shumë se gjysmën e asaj sa ka nevojë. Në bazë të këtyre të gjeturave Komisioni i Auditimit rekomandon Bordin e Drejtorëve që të bëjë një riorganizim të njësisë Punuese të Dragashit. Nga kjo Bordi i Drejtorëve mori këtë vendim: Njësia Punuese e Dragashit të shkarkohen me së paku nga 3 punëtor, të cilët do të sistemohen në njësinë Punuese të Prizrenit në kuadër të riorganizimit me qëllim të zbutjes së mbulimit të koeficientit të punës (mbulimit të konsumatoreve me punëtorë në 1000 konsumator).
 - Bordi i Drejtorëve aprovoi konkluzionin e Komisionit të Auditimit, njëherit mori këtë vendim: Për çdo aktivitet nga Zyra e Prokurimit para se të bëhet njoftimi i Kontratës në KRPP të njoftohet së pari Komisioni i Auditimit. Nëse pas 48 orëve Komisioni i Auditimit nuk jep ndonjë koment apo sygjërim, Zyrtari i Prokurimit të KRU "Hidroregjioni Jugor" SH.A Prizren mund të vazhdon me aktivitetin e prokurimit.
 - Bordi i Drejtorëve aprovoi konkluzionin e Komisionit të Auditimit njëherit mori këtë vendim: I gjithë komunikimi që realizohet ndërmjet zyrtarëve të KRU "Hidroregjioni Jugor" SH.A Prizren me Bordin e Drejtorëve, Komisionin e Auditimit dhe Komitetet tjera, shkresat ta kenë me vete aktin e besueshmërisë dhe të jenë të protokoluara.
 - Bordi i Drejtorëve në përputhje me nenin 31 të Ligjit për Ndërmarrjet Publike Nr.03/L-087 për raportet vjetore dhe tremujore, Bordi i Drejtorëve mori këtë vendim :Bordi i Drejtorëve pas shqyrtimit të bërë njëzëri Aprovoj-miratojë Raportin vjetor Operativ dhe Financiar për vitin 2015.
 - Bordi i Drejtorëve i Kompanisë Rajonale të Ujësjetës "Hidroregjioni Jugor" Sh.A me seli në Prizren, në përputhje me nenin 29 të Ligjit për Ndërmarrjet Publike Nr.03/L-087 për Raportet mbi Përbushjen e Nevojave të Klientëve dhe nenin 16 Ligji Nr. 04/L-111 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr.03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, pas shqyrtimit të bërë Aprovoj-miratojë Raportin mbi Sondazhin për Hulumtim të Opinionit për Kënaqshmërinë e Konsumatorëve me Sherbimet e KRU "Hidroregjioni Jugor" Sh.A Prizren për vitin 2015 njëzëri .

- Bordi i Drejtoreve në takimin e mbajtur me date 29.03.2016 arriti në konkluzionin se Bordi i Drejtoreve respekton Vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës për mos kompenzimin e Komiteteve të përkohshme të Bordit të Drejtoreve. Vërejtje; Përmes këtij konkluzioni anulohet vendimi i datës 29.02.2016 i Bordit të Drejtoreve sipas të cilit parashihej që anëtarët e Komiteteve të Bordit të Drejtoreve për takimet e mbajtura në Kompani të paguhen (për një takim në muaj) me mëditje sipas tarifave të përcaktuara me Vendim të Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 01/119 të datës 13.03.2013.
 - Bordi i Drejtoreve në bazë të raportit nga Komiteti për Definimin e Pronësisë si dhe me propozimin e përfaqësuesit në emer të Aksionarit respektivisht Analistit në Departmentin e NJPMNP-MZHE mori këtë vendim:
 - Bordi i drejtoreve merr vendim që Komiteti për Definimin e Pronësisë e ka përfunduar punën dhe misionin e këtij komiteti, pasi ka formuar një komison të mbrendshëm për Definimin e Pronësisë i cili do ti përgjigjet dhe raportoje drejtpërdrejtë Bordit të Drejtoreve.
- Bordi i Drejtoreve në takimin e mbajtur me datë 29.04.2016 në përputhje me nenin 31(31.2) të Ligjit për Ndërmarrjet Publike Nr.03/L-087 për raportet tremujore dhe nenin 18 Ligji Nr. 04/L-111 Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, Bordi i Drejtoreve i K.R.U "Hidroregjioni Jugor" Sh.A. pas shqyrtimit të bërë Apropoj-miratoj Raportin Operativ dhe Financiar për Tre Mujorin e Parë 2016.
 - Bordi i Drejtoreve bazuar në nenin 20 dhe 22 të ligjit Nr.03/L-87 për Ndërmarrjet Publike dhe Neni 12 të ligjit Nr. 04/L-111, për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, Politikës së Kompensimit për Stafin Menaxhues, respektivisht Politikës mbi Kompensimin për stimulimin e efektshmerisë në bazë të performancës për Bordin e Drejtoreve dhe Zyrtarët e KRU "Hidroregjioni Jugor" Sh.A, me propozim të Komisionit të Auditimit, Bordit të Drejtoreve ka Aprovuar DEKLARATËN PËR POLITIKËN E KOMPENSIMIT PËR DREJTORËT E BORDIT DHE ZYRTARËT E KRU "Hidroregjioni Jugor"Sh.A. për vitin 2016.
 - Bordi i Drejtoreve Apropoj- miratoj Draft Pasqyrat Financiare 2015 të Auditorit të Jashtëm.
- Bordi i Drejtoreve në takimin e mbajtur me datë 30.05.2016 Apropoj- miratoj Pasqyrat Financiare 2015 të Auditorit të Jashtëm dhe Letrën për Menaxhmentin dërguar nga Auditori i Jashtëm
- Bordi i Drejtoreve në Mbledhjen e Përgjithëshme Vjetore me Aksionarin me datë 17.06.2016 Apropoi Pasqyrat Financiare të Audituar nga Auditori i Jashtëm për 2015.
 - Bordi i Drejtoreve në Mbledhjen e Përgjithëshme Vjetore me Aksionarin Apropoj- Miratoi Raportin vjetor për vitin 2015.
 - Bordi i Drejtoreve në Mbledhjen e Përgjithëshme Vjetore me Aksionarin Miratoi Performancën e Menaxhmentit të Kompanisë.
- Bordi i Drejtoreve në takimin e mbajtur me datë 28.06.2016 aprovoi-miratoi kërkesën e Kryeshefit Ekzekutiv për aplikim për kredi e cila do të shërbejë si mbështetëse e Projektit të Ujërave të Zeza. Në rast se lejohet kjo kredi nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Bordi i Drejtoreve do të njoftohet para çdo transaksioni nga kjo llogari.
 - Bordi i Drejtoreve aprovoi-miratoi Raportin e performancës për periudhën Janar- Qershor 2016.
 - Bordi i Drejtoreve në përputhje me nenin 17 të Ligjit Nr.04/L-111 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr.03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, për Plan-Biznes, miratoi Revidimin e Plan-Biznesit për vitin 2016-2018 për K.R.U "Hidroregjioni Jugor"Sh.A me seli në Prizren si dhe me ndryshimin e organogramit.
- Bordi i Drejtoreve në mbledhjen e datës 29.07.2016 mori vendim që punëtorët e KRU "Hidroregjioni Jugor" SH.A Prizren, duke filluar nga Kryeshefi Ekzekutiv dhe për të gjithë punëtorët e kompanisë, të paguhen në bazë të mbulueshmërisë operative duke i shpërndarë edhe shpenzimet e administratës qendore nëpër secilën njësi punuese të KRU "Hidroregjioni Jugor" SH.A Prizren, në bazë të numrit të konsumatoreve. Vendimi hyn në fuqi për zbatim nga data 1 Korrik 2016.
 - Bordi i Drejtoreve në përputhje me nenin 31(31.2) të Ligjit për Ndërmarrjet Publike Nr.03/L-087 për raportet tremujore dhe nenin 18 Ligji Nr. 04/L-111 Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr.

03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, Bordi i Drejtorëve i K.R.U "Hidroregjioni Jugor" Sh.A. aprovoj-miratoj Raportin Financiar për Tre Mujorin e Dytë 2016.

- Bordi i Drejtorëve bazuar në Nenin 4, Paragrafi 3 të Ligjit të Nr.03/L-212 të Punës aprovoi-miratoi ndryshimin dhe plotësimin e "Manualit mbi orarin e punës të KRU "Hidroregjioni Jugor" SH.A Prizren. Ky Manual ndryshohet dhe emërohet "Rregullore mbi Orarin e Punës të KRU "Hidroregjioni Jugor" SH.A Prizren.
 - Bordi i Drejtorëve në takimin e mbajtur me datë 30.08.2016 për shkak të fluksit të madh të konsumatorëve për ta shfrytëzuar të drejtën ligjore që të përfitojnë nga Ligji për Faljen e Borxheve Publike, në kuadër të shërbimeve të ujësjellësit dhe kanalizimit, i cili do të shfuqizohet me 02.09.2016, mori vendim që Zyra për Faljen e Borxheve në 4 njësitë punuese të KRU "Hidroregjioni Jugor" SH.A Prizren (Prizren, Suharekë, Malishevë dhe Dragash), nga dita e sotme e deri të premtën më 02.09.2016, të zgjatet orari i punës deri në orën 19:00.
 - Bordi i Drejtorëve në takimin e mbajtur me datë 29.09.2016 mori vendim që, nga data 01.10.2016, Sekretarja e Kompanisë të fillon punën, kurse U.D. i Sekretarit të Kompanisë, të kthehet në pozitën e mëparshme.
 - Bordi i Drejtorëve në takimin e mbajtur me datë 28.10.2016 në përputhje me nenin 31(31.2) të Ligjit për Ndërmarrjet Publike Nr.03/L-087 për raportet tremujore dhe nenin 18 Ligji Nr. 04/L-111 Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, Bordi i Drejtorëve i K.R.U "Hidroregjioni Jugor" Sh.A, Aprovoj-miratojë Raportin Operativ dhe Financiar për tre mujorin e tretë 2016.
 - Bordi i Drejtorëve i Kompanisë Rajonale të Ujësjellësit "Hidroregjioni Jugor" Sh.A me seli në Prizren në përputhje me nenin 30 të Ligjit për Ndërmarrjet Publike Nr.03/L-087 për Plan-Biznes, Aprovoj-miratojë Plan - Biznesin për vitin 2017-2019.
 - Mbështetur në Ligjin Nr. 03/L-087, "Mbi Ndërmarrjet Publike", në Ligjin Nr. 02/L-123, "Për Shoqëritë Tregtare", në Vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 03/74, datë 14.07.2009 dhe në Vendimin e Komisionit të Ministrave Nr. 218/1, datë 30 /09 /2009, Bordi i Drejtorëve i Shoqërisë Aksionare K.R.U "Hidroregjioni Jugor" SH.A, miratoi Aneks Statuti i Shoqërisë Aksionare Kompania Rajonale e Ujësjellësit "Hidroregjioni Jugor" SH.A.Prizren. U ngarkua Sekretari i Kompanisë të bejë këtë ndryshim në Agjencinë e Regjistrimit të Biznesëve në Republikën e Kosovës.
 - Bordi i Drejtorëve i Kompanisë Rajonale të Ujësjellësit "Hidroregjioni Jugor" Sh.A me seli në Prizren, njëzëri vendosi që kontrata e punës së Sekretarës së Kompanisë, Zyrtarit Kryesor Financiar dhe Auditorit të Brendshëm të ju vazhdohet në kohë të pacaktuar nga data 01.11.2016.
 - Bordi i Drejtorëve në takimin e mbajtur me datë 25.11.2016 në përputhje me nenin 7. pika 2. të Statutit të KRU "Hidroregjioni Jugor" aprovon njëzëri pa vërejtje "Rregulloren për mbrojtje nga zjarri" në K.R.U. „Hidroregjioni Jugor" sh.a, në Prizren.
 - Bordi i Drejtorëve në takimin e datës 23.12.2016 rekomandoi Kryeshefin Ekzekutiv që të mirren masa ndëshkuese sipas propozimit të Komisionit të Auditimit për -10% të pagës për udhëheqësit e njesive Suharekë, Malishevë dhe Dragash, udhëheqësi i shërbimit për konsumator dhe shefi kontrollës, kontrollorët, inkasantet dhe lexuesit e ujëmatësve, deri në performancë pozitive për tri njësitë në fjalë. Masa ndëshkuese të jetësohet nga janari 2017.
- Poashtu Komisioni i Auditimit rekomandon Kryeshefin Ekzekutiv të kërkoj raport nga udhëheqësit e tri njesive në fjalë, dhe në raport të paraqiten faktorët objektive dhe subjektive që kanë ndikuar në mos arritje të performancës gjatë viti 2016, gjithashtu të japin edhe zotim sa kërkojnë afat kohor për përmirësimin e performancës së këtyre njesive.
- Bordi i Drejtorëve është pajtuar që të shperblehen me mjete monetare në vlerë prej 100.00€ dhe me mirënjohje 11 punëtorët që kanë treguar angazhim të veçantë gjatë vitit 2016 të cilët janë propozuar nga komisioni për shperblime
 - Bordi i Drejtorëve në përputhje me nenin 7. pika 2. të Statutit të KRU "Hidroregjioni Jugor" aprovoi njëzëri pa vërejtje "Rregulloren për udhëtimet zyrtare" në K.R.U. Hidroregjioni Jugor" sh.a, në Prizren.

- Është bërë shqyrtimi dhe aprovimi i raportëve tremujore për vitin 2016 (duke u bazuar në raportet mujore); dhe në kornizën ligjore të Ligjit për NP.
- Janë dorëzuar të aprovuara raportet si në vijim: Raporte tremujore për aksionarin (MZHE); (nga raporti TM1 deri të raporti për TM4),dhe Raporte mujore për ARRU-në;

Aktivitetet tjera të Bordit të Drejtorëve gjatë vitit 2016

- Bordi i Drejtorëve ishte në kontakte të vazhdueshme me Menaxhmentin e Kompanisë.
- Në vazhdimësi ka kërkuar dhe është njoftuar, në kontakte direkte por edhe në formë të shkruar, për gjendjen dhe zhvillimet në kompani.
- Është mbikqyrë menaxhimi kompanisë dhe janë dhënë këshillat e nevojshme për Kryeshefin Ekzekutiv.
- Në takimet e rregullta janë mbikqyrë të gjitha ecuritë e biznesit, mbarëvajtja e tyre sipas vendimeve të Bordit si dhe aspekti ligjorë i vendimeve të Menaxhmentit të kompanisë. Lidhur me këtë Bordi i Drejtorëve është i informuar për të gjitha vendimeët dhe zhvillimet e rëndësishme.
- Bordi i Drejtorëve në përputhje me nenin 29 të Ligjit për Ndërmarrjet Publike Nr.03/L-087 për Raportet mbi Përbushjen e Nevojave të Klientëve dhe nenin 16 Ligji Nr. 04/L-111 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr.03/L-087 për Ndermarrjet Publike në takimin e mbajtur me datë 29.02.2016, Aprovoj-miratojë Raportin mbi Sondazhin për Hulumtim të Opinionit për Kënaqshmërinë e Konsumatorëve me Sherbimet e KRU" Hidroregjioni Jugor" Sh.A për vitin 2015.
- Bordi i Drejtorëve gjatë vitit 2016 i ka mbajtur 13 takime të rregullta me përbërje të plotë.
- Në kuadër të Bordit të drejtorëve kanë vazhduar të funksionojnë këto komitete;
 1. Komisioni i Auditimit (12 Takime)
 2. Komiteti për hulumtime dhe teknologji (0 Takime)
 3. Komiteti i Financave (03 Takime)
 4. Komiteti për Staf dhe Shpërblime (04 Takime) dhe
 5. Komiteti për Definiminë e Pronësisë (01 Takim).

Bordi i Drejtorëve falënderon Kryeshefin Ekzekutiv, stafin menaxhues të Kompanisë dhe gjithë punëtorët për përshtetjen e tyre në rritjen e performancave të kompanisë dhe në përmirësimin e shërbimeve ndaj konsumatorëve. Bordi shprehë një mirënjohje të veçantë për të gjithë donatorët (KFW, Dorsch-CDI), MZHE dhe Kuvendet Komunale për bashkëpunim dhe mbështetje në realizimin e shumë projekteve për në interes të Kompanisë.

Komisioni i Auditimit ka mbajtur dymbëdhjetë (12) takime të rregullta, sipas procesverbaleve takimet janë mbajtur në këto data: 22.01.2016; 18.02.2016; 21.03.2016; 28.04.2016; 24.05.2016; 23.06.2016; 22.07.2016; 24.08.2016; 23.09.2016; 26.10.2016; 23.11.2016; dhe 20.12.2016.

Raporti vjetor i Komisionit të Auditimit, të KRU" Hidroregjioni Jugor" sh.a në Prizren, në formë përmbledhëse përfshinë aktivitetet dhe punët të cilat i ka realizuar gjatë vitit 2016.

Bazë apo burim i të dhënave gjatë përgatitjes së këtij raporti vjetor, janë procesverbalet zyrtare të mbajtura në takimet e Komisionit të Auditimit.

Në bazë të procesverbaleve, për këtë periudhë raportuese janë mbajtur gjithsejt 12 takime të rregullta të komisionit, në të cilat janë diskutuar dhe janë marrë disa vendime. Ndërsa shumë çështje tjera janë shqyrtuar drejtpërdrejt në takimet e rregullta të Bordit të Drejtorëve.

Në vazhdim në mënyrë kronologjike janë paraqitur të gjitha takimet dhe aktivitetet e Komisionit të Auditimit.

Në takimin e parë të këtij viti, të mbajtur me 22.01.2016, janë shqyrtuar dhe diskutuar disa raporte dhe çështje, sikurse janë:

- Raporti për Asete dhe Stoqe,
- Raporti i faljeve të borxheve dhe ndikimi i tyre,
- Raportimi i performancës të TM4/2015, ku të pranishëm ishin edhe menaxherët e katër Njësive Punuese, si dhe
- Çështje tjera të ndryshme.

Konkluzionet, vendimet dhe rekomandimet e dhëna të Komisionit të auditimit, kanë qenë:

- Komisioni i Auditimit rekomandon Bordin e Drejtoreve që në bashkëpunim me zyrtarët e kompanisë të përgatisin kërkesën për Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik në lidhje me riorganizimin e hidroekonomisë së ujërave për regjionin e Prizrenit.
- Komisioni i Auditimit kërkoi nga Zyrtari për Asete, në takimin e ardhshëm të përgatisë një raport me zërat e asetëve në mënyrë të specifikuar me qëllim të informimit sa më të mirë në lidhje me asetet e kompanisë.
- Kryesuesi i Komisionit kërkoi nga udhëheqësit e njësive që mbrenda periudhës gjatë mujore te evidentohen të gjithë konsumatorët që kanë borxhe, si dhe në bashkëpunim me Zyren Ligjore e cila duhet ti përgatis ftesat edhe ti informoj konsumtorët për shumën e borxhit, sa i falen sa duhet të paguaj, dhe ti fton për nënshkrim të kontratës për falje të borxhit. Në mënyrë që të rritet performanca kërkoi që të aktivizohet sa më shumë puna në teren.
- Komisioni i Auditimit i propozon Bordit të Drejtoreve, të caktohen dhe të mbahen takime me përfaqësuesit e institucioneve nëpër secilat Njësi Punuese të KRU "Hidroregjioni Jugor" SH.A Prizren me qëllim të rritjes së performancës së kompanisë.
- Komisioni i Auditimit aprovoj-miratoi raportin e performancës financiare për tremujorin e katërt të vitit TM4 2015, me mundësi të plotësimit të atyre çka u diskutua gjatë takimit.

Takimi i dytë i Komisionit të Auditimit, është mbajtur me datë 18.02.2016, ku është bërë shqyrtimi dhe diskutimi i disa çështjeve:

- Planifikimi i zyrës së prokurimit për vitin 2016, si dhe raporti i aktivitetëve të Zyres së Prokurimit gjatë vitit 2015.
- Raporti i detajuar për stoqet (materialet si gypat, ujematësit e të ngjashme) nëpër Njësi.
- Raport i specifikuar qartë për të gjithë stafin në të gjitha Njësitë Punuese të KRU "Hidroregjioni Jugor" Sh.a Prizren dhe përgaditjet e tyre profesionale, si dhe
- Çështje tjera të ndryshme.

Pas shqyrtimit të këtyre pikave Komisioni i Auditimit ka konkluduar dhe ka marrë këto vendime:

- Komisioni i Auditimit rekomandon Bordin e Drejtoreve që për çdo aktivitet nga Zyra e Prokurimit para se të bëhet njoftimi i Kontratës në KRPP të njoftohet së pari Komisioni i Auditimit. Nëse pas 48 orëve Komisioni i Auditimit nuk jep ndonjë koment apo sygjërim, Zyrtari i Prokurimit të KRU "Hidroregjioni Jugor" SH.A Prizren mund të vazhdon me aktivitetin e prokurimit.
- Komisioni i Auditimit rekomandon Bordin e Drejtoreve që i gjithë komunikimi që realizohet ndërmjet zyrtarëve të KRU "Hidroregjioni Jugor" SH.A Prizren me Bordin e Drejtoreve, Komisionin e Auditimit dhe Komitetet tjera, shkresat ta kenë me vete aktin e besueshmërisë dhe të jenë të protokoluara.
- Komisioni i Auditimit kërkoi nga kryetari për regjistrim që në takimin e ardhshëm ta përcjellë procesverbalin e regjistrimit qëndror vjetor të kompanisë.
- Komisioni i Auditimit rekomandon që në takimin e ardhshëm të paraqiten të gjitha tabelat me të dhënat për stafin për të gjitha njësitë punuese të KRU "Hidroregjioni Jugor" SH.A Prizren, të rifreskohen dhe të ju shtohet tabela e koeficientit dhe ti bashkangjiten të gjitha komentet.
- Komisioni i Auditimit në bazë të gjeturave në Raportin e Auditimit të Brendshëm, njësia punuese e Dragashit ka punëtor më shumë se gjysmën e asaj sa ka nevojë. Në bazë të këtyre të gjeturave Komisioni i Auditimit rekomandon Bordin e Drejtoreve që të bëjë një riorganizim të njësive Punuese të Dragashit.
- Komisioni i Auditimit rekomandon Bordin e Drejtoreve që pagat nëpër njësitë punuese të KRU "Hidroregjioni Jugor" SH.A Prizren, të paguhën në bazë të % së inkasimit.

Takimi i tretë i Komisionit të Auditimit, është mbajtur me datë 21.03.2016 ku është bërë shqyrtimi dhe diskutimi i disa çështjeve:

- Shqyrtimi dhe aprovimi i Raportit Vjetor të punës së Auditorit të Brendshëm për vitin 2015.

- Prezantimi i planit kontabel, emërtimi i llogarive (kontove) si dhe qarkullimi me gjendjen fillestare debi e kredi, qarkullimi debi e kredi si dhe salldot debi e kredi dhe totali i përgjithshëm përfundimisht me datën 31/12/2015.
- Çështja e Auditimit të Pasqyrave Financiare për vitin 2015 nga auditori i licensuar.
- Prezantimi i Deklaratave të TVSh-së për Janar e Shkurt 2016.
- Njoftimi i aktiviteteve të prokurimit të paraqiten për Komisionin e Auditimit, periudha Janar, Shkurt dhe Mars.
- Të paraqitet lista e automjeteve të kompanisë KRU (lloji i automjetit, viti i prodhimit, viti i furnizimit) në Exel, si dhe
- Të tjera.

Pas shqyrtimit të këtyre pikave, Komisioni i Auditimit ka konkluduar dhe ka marrë këto vendime:

- Komisioni i Auditimit aprovon raportin vjetor të punës dhe aktiviteteve të Auditorit të Brendshëm për vitin 2015, njëherit Komisioni i Auditimit komplimentoi punën dhe angazhimin e Auditorit të Brendshëm, gjithashtu i ofruan mbështetje të mëtutjeshme nga Komisioni i Auditimit dhe Menaxhmenti i Kompanisë.
- Komisioni i Auditimit aprovoi të gjitha kërkesat për iniciimet e aktiviteteve të prokurimit meqenëse janë kontratë korniza dhe janë të nevojshme për ecurinë e punës së kompanisë përveç iniciimit të aktivitetit Furnizim me sanitari deri në një sçarim tjetër shtesë për Komisionin e Auditimit.
- Komisioni i Auditimit rekomandon Auditorin e Brendshëm që të kryej Auditim në Njësinë Punuese Suharekë dhe Malishevë.

Takimi i katërt i Komisionit të Auditimit, është mbajtur me datë 28.04.2016 ku është bërë:

- Shqyrtimi dhe Aprovimi i Raportit TM1/2016 i Auditorit të Brendshëm.
- Shqyrtimi i pasqyrave financiare për vitin 2015 të audituara nga auditori i licensuar.
- Performanca financiare mars 2016 dhe TM1/2016.
- Raporti i aktiviteteve të prokurimit janar- mars 2016. Si dhe
- Të tjera.

Pas shqyrtimit të këtyre pikave Komisioni i Auditimit ka konkluduar dhe ka marrë këto vendime:

- Komisioni i Auditimit kërkon që Njësisë Punuese Malishevë dhe Suharekë të ju dërgohet me shkrim vendimi për rregullim dhe vënie në funksion të dy pompave të derivative me qëllim ngritjes së kontrollit të brendshëm dhe sigurisë fizike të stoqeve.
- Të caktohet një takim me Ministrin Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor me qëllim të diskutimit të vonesave në aspektin administrativ, për punimet e Projektit të Ujërave të Zeza, projekt ky i financuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës, Qeveria Gjermane dhe Kuvendi Komunal i Prizrenit. Të diskutohet shqyrtimi i mundësisë që mos të ndërpriten punimet gjatë sezonit të verës Qershor-Shtator 2016 (Projekti i Ujërave të Zeza). Në takim të jenë pjesëmarrës edhe Zyrtaret e Kuvendit Komunal Prizren.
- Të caktohet një takim urgjent me Ministrin e Zhvillimit Ekonomik në lidhje me shqyrtimin sa më të shpejtë të pozicionit të objektit të KRU "Hidroregjioni Jugor" SH.A Prizren ku vepron, gjithashtu në këtë takim të diskutohet edhe çështja e Riorganizimit të Hidroekonomisë së Ujërave për Regjionin e Prizrenit.
- Komisioni i Auditimit propozon që përmes shkresave zyrtare të ju drejtohet KK Prizren respektivisht Drejtorisë për Pronësi dhe Arkivit dhe të kërkohet një kopje të historiatit për ndërrim të emrit nga pronari i gjertanishëm P.SH/ Bashkësia e Ujërave "Lumbardhi"- Prizren në pronarin e ri Kompania Rajonale e Ujësjellësit "Hidrosistemi Radoniqi" SH.A, aktit të transferit si dhe Çertifikaten e Regjistrimit. Të kompletohet lënda dhe ti përcillet Bordit të Drejtorëve.
- Komisioni i Auditimit Apropoj-miratoi Raporti tremujor (TM1) të punës së Auditorit të Brendshëm për vitin 2016, njëherit kërkoi nga Auditori i Brendshëm që në takimin e ardhshëm të raportoj lidhur me pozicionin e të hyrave të shtyra të prezantuara në Pasqyrat Financiare 2015 në vlerë prej 496,000.00€.
- Komisioni i Auditimit shqyrtoi Draft Raportin e Pasqyrave Financiare 2015 të Auditorit të Jashtëm dhe e përcjellë te Bordi i Drejtorëve për aprovim.
- Komisioni i Auditimit aprovoj Raportin e Performances financiare për periudhën TM1 2016.

- Komisioni i Auditimit propozoi që Riorganizimin e shërbimit të kontrollës dhe inkasanteve të jetë pikë e diskutimit në takimin e ardhshëm të Bordit të Drejtoreve. Gjithashtu u propozua që në takim të Bordit të Drejtoreve të diskutohet edhe çështja e borxheve të këqija.

Takimi i pestë i Komisionit të Auditimit, është mbajtur me datë 24.05.2016 ku është bërë:

- Shqyrtimi i Raportit të Auditorit të Brendshëm lidhur me pozicionin e Të Hyrave nga Grantet, të vitit 2015.
- Shqyrtimi i shlyerjes së borxheve nga institucionet publike, ndërmarrjet e vogla dhe të mesme.
- Raporti mbi performancën e muajit Prill 2016.
- Të ndryshme.

Pas shqyrtimit të këtyre pikave Komisioni i Auditimit ka konkluduar dhe ka marrë këto vendime:

Ndërsa hapjen e kanalit për shkake të terrenit të fortë dhe mungesës së kapacitetit të makinerisë, kompania jonë është detyruar që ta angazhojë një kompani private për hapjen e kanalit.

Rrjeti ka gjatësi L=850m, diametri i gypit 90mm.

* *Projektet -Investimet nga CDI-a*

-“Programi mbështetës për ujë dhe kanalizim” : Faza V të zonave rurale (Sistemet e reja të ujësjellësit) Suharekë, në vazhdim.

- Rehabilitimi i sistemit të ujësjellësve në zonat rurale, Faza V për Suharekë, në vazhdim.

* *Pastrimi dhe sigurimi i zonës së parë mbrojtëse në fshatrat* : Doberdelan, Sllapuzhan, Bllac, Baqec, Grikoc.

Me fshatrat Muhlan, Dvoran dhe Vranqi ende nuk kemi filluar pasi që disa prej banorëve po e kundërshtojnë këtë investim.

* *Rehabilitimi i burimit të ujit në Fshatin Peqan-Suharekë*

- Është përfunduar pozicioni i minimumit në galeri në ditët në vijim do të fillojnë punimet në ndërtimin e kaptazhes.

* *Pastrimi i rrethojave te Rezervuarit dhe stacionit pompave*

Në fshatin Savrovë është bërë pastrimi i sipërfaqes për rreth rezervuarit dhe stacionit të pompave.

* *Testimi i dy burimeve të ujit në fshatin Budakovë*

Në fund të muajit, inxhinierët e kompanisë së bashku me punëtorët e operativës, kanë bërë matjet në dy burime, të quajtura ‘ Vrella e bardhë dhe e zezë ‘, në lokacionin mbi fshatin Budakovë, në 1330 mlm. Me ç`rast janë matur sasishtë e prurjeve të këtyre burimeve :

1. Vrella e Zezë, q=8.28 l/s, z=1305 mlm

2. Vrella e Bardhë, $q=3.40$ l/s, $z=1290$ mlm.

**Zëvendësimi i pompës 18.5 kw me pompën 12 kw në Doberdelan.*

Për arsye të zvogëlimit të sasisë së ujit në pus dhe si pasojë e fuqisë së madhe të pompës uji i nxjerr nga pusi me pompën ekzistuese është ka qenë i turbullt dhe për këtë është zëvendësuar me pompës më të vogël (investimi nga CDI-a)

**Detektimi i rrjetit të ujësjellësit për humbje të ujit.*

Gjatë këtij muaji, ekipi i operativës dhe mirëmbajtjes, pas inspektimit të pusetave të kanalizimit në një pjesë të qytetit dhe në fshatin Sallagrazd kanë identifikuar dhe rregulluar 4 defekte me rrjedhje të konsiderueshme të ujit.

Aktivitetet Janar-Dhjetor, 2016 – Njesia Malishevë

**Furnizimi me ujë, Janar-Dhjetor - ka qenë i mirë dhe pa reduktime në perjashtim në periudhën e verës ku kemi pasur reduktime në disa fshatra: Carralluke, Drenovc si dhe në pikat me të larta në fshatin Bajë dhe në Malishevë, përshkak të ngritjes së kërkesave për uje si dhe rritjes së temperaturave .*

**Analizat e ujit, Janar-Dhjetor - janë realizuar 60 mostra të analizave bakteriologjike dhe 60 mostra të analizave fiziko-kimike dhe sipas rezultateve 6 mostra nuk i përgjigjen standardeve (ISHP).*

**Aktivitete lobimi - kontakte të rregullta me perfaqësuesit e Drejtorisë së Shërbimeve Publike, atë të Urbanizimit si dhe me Drejtorin e Financave, kontakte me zyrtarët e KEDS-it për montimin e rrjetit elektrik në fshatrat: Senik dhe Maxharr deri te stacioni i pompave.*

**Rregullimi i defekteve, Janar-Dhjetor - rrjeti primar 235 defekte, rrjeti sekondar 265 defekte, deblokimi i kanalizimeve 71 ndërhyrje dhe 10.9 km kanal të pastruar, ankesat teknike 107, ankesat komerciale 108, njoftime për shkyqje 456, kyqje të reja 323, amvisëri 302, lokale 21, procesverbale të shkyqjeve 230, verifikim të ujëmatësive 2183, ujëmatësa të ndërruar 129, ujëmatësa të montuar 112, kyqje ilegale 3, rikyqje 1, shkyqje për mospagesë 1, bllobim të ujëmatësive 74, riprogramim të borgjit kontrata 75.*

Aktivitetet Janar-Dhjetor, 2016 - Njesia Dragash

**Furnizimi me ujë ka qenë i rregullt në përgjithsi, këtë situat stabile e kanë mundësuar aktivitetet të cilat kanë ndodhë gjatë muajve Janar – Dhjetor 2016, fillimisht me sigurimin e mjaftushëm të ujit për trajtim, pastrimin e pusetave dhe punë tjera në kaptazhë në fshatin Radesh. Është pastruar edhe kaugullatori.*

**Trajtimi i ujit (sendimentimi,kaugulimi,filtrimi dhe klorizimi) është bërë në vazhdimsi.*

**Aktivitete nga ekipi teknik në operativë janë bërë këto:47 raste sanim në rrjetin e ujësjellësit, 50 ndrrime të ujëmatësive, 29 montim i ujëmatësive të reja, 165 pastrim dhe kontrole të ujëmatësive, 25 kyqje në rrjetin e ujësjellësit, 15 raste të pastrimit të pusetave, 15 sanime në rrjetin e kanalizimit, 539.m.deblokime dhe pastrime në rrjetin e kanalizimit, 48 pastrime të pusetave të kanalizimit, 90 angazhime tjera të ekipit teknik.*

**Punët në administratë janë të azhuruara sipas rregullave që i aplikon kompania duke i përfshirë punët nga lëmia e financave dhe atyre të administratës së përgjithëshme.*

**Këto aktivitete e përfshijnë zonën e veprimt në Dragash, në fshatin Pllavë, në fshatin Shajne dhe në fshatin Brezne.*

**Prodhimi i ujit: Janar-Dhjetor janë prodhuar 410,758.00 m³ ujë dhe kjo sasi ka kushtëzuar furnizim të rregullt për të gjithë konsumatorët.*

**Humbjet e ujit: Janar-Mars arrijnë rreth 64.4 % për shkak të rrjetit të vjetëruar të ujësjellësit.*

3.2.1 AKTIVITETET NGA SHËRBIMI RAJONAL PËR KONSUMATORË

Aktivitetet kryesore

- Është bërë leximi i ujëmatësve nga Inkasantët (lexuesit) e terrenit .
- Janë shtyp dhe shpërnda faturat e shërbimeve të ujësjellsit mbrenda afatit ligjor te secili konsumatorë.
- Janë vizituar nga inkasantët të gjithë konsumatorët në pronat e tyre ku është kërkuar inkasimi i mjeteve për shërbimet e ujësjellsit .
- Janë shqyrtuar të gjitha ankesat teknike dhe komerciale të konsumatorëve

Janë vizituar nga ekipet e kontrollës konsumatorët për mospagesë të shërbimeve të ujësjellsit, të cilët nuk paguajn faturat dhe atyre që kanë borxhe të mëdha ndaj KRU “ Hidroregjioni Jugor” sha. Secilit konsumatorë të vizituar nga ekipet e kontrolles i është lënë procesverbali ku ceket borxhi dhe afati për pagesën e borxhit.

- Janë bërë kontrolle në teren te konsumatorët nga ekipet e kontrollës edhe për shqyrtim të ankesave të konsumatorëve dhe regjistrime të konsumatorëve të rinj.
- Janë kontaktuar konsumatorët institucional të cilët kanë borxhe e të cilët në përfundim të buxhetit kanë mundësi buxhetore ti paguajn faturat e akumuluar.

Problemet e hasura gjatë kësaj periudhe

- Mos zgjidhja e problemit të rasteve sociale , kjo kategori e konsumatorëve po ndikon në mungesën e inkasimit te kjo kategori e konsumatorëve.
- Pamundësia e leximit të ujëmatësve për çdo muaj te një numër i konsumatorëve, nga inkasantët tek shtëpit (pronat) e konsumatorëve, pasi në kohën kur bëhet leximi nuk gjenden në shtëpi apo edhe nuk i hapin dyert për t'u mundësuar inkasantëve leximin e orëve (kryesisht te konsumatorët që jetojnë në ndërtesa kolektive-banesa).
- Moszgjidhja e problemit të borxhit për shpenzimet e ujit mes shitësit dhe blerësit të pronës, pronave të uzurpura që nga pas lufta, pronat që kanë qenë nën administrimin e Agjencionit Kosovar të Pronës.

Masat e realizuara/ mosrealizuara nga periudha paraprake

- Rritje të numrit të konsumatorëve në zonën e shërbimit si rezultat i legalizimit të konsumatorëve ilegal apo edhe pëlqimeve për kyqje.
- Në rënien e inkasimit gjate tetor ka ndikuar, mospagesa e konsumatorëve
- Takime më përfaqësues nga konsumatorët e bizneseve dhe institucional dhe bisedimi i mundësive për pagesën e borxheve.

Masat e propozuara për periudhën në vazhdim

- Trajtimi i një numri më të madh të konsumatorëve pas fillimit të aplikimit të faljes së borxheve
- Vazhdimësia e mbështetjes së inkasantëve nga ekipi i kontrolles te konsumatorët të cilët në vijimësi nuk paguajn faturat
- Mbikqyrja dhe monitorim i vazhdueshëm i inkasantëve në arritjen e limitive në inkasim
- Regjistrimi i vazhdueshëm i konsumatorëve që dëshirojnë të kyqen në shërbime të ujësjellsit dhe kanalizimit
- Kontakte të vazhdueshme me konsumatorë të cilët kanë të papaguara të muajt e fundit dhe borxhet mbi 100 euro

3.2.2 RAPORTIMI EKIPES SË KONTROLLES DHE SHKYÇJES

2015

Nr.	Njesia Operative	Lidhjet e reja	Ç'kyçjet	Lidhje ilegale	Verifikimi i ujëmatësve
1	Prizren	1432	43	20	8720
2	Suharekë	260	48	49	8393
3	Malishevë	472	84	68	4454
4	Dragash	22	1	0	56
5	KRU "Hidroregjioni Jugor"	2.186	176	137	21.623

2016

Nr.	Njesia Operative	Lidhjet e reja	Ç'kyçjet	Lidhje ilegale	Verifikimi i ujëmatësve
1	Prizren	955	4	5	38.831
2	Suharekë	144	40	27	16.585
3	Malishevë	461	61	22	12.789
4	Dragash	5	0	0	0
5	KRU "Hidroregjioni Jugor"	1.562	105	54	68.204

3.2.3 RAPORTI I ANKESAVE

2015

MUAJI	JAN	SHKU	MAR	PRILL	MAJ	QER	KORR	GUSH	SHTA	TET	NEN	DHJET	TOTAL
ANK. TEK.	53	49	54	64	60	86	73	84	87	112	86	70	878
ANK. KOM.	52	51	44	36	26	27	31	38	31	55	54	65	510
TOTAL	105	100	98	100	86	113	104	122	118	167	140	135	1.388

2016

MUAJI	JAN	SHKU	MAR	PRILL	MAJ	QER	KORR	GUSH	SHTA	TET	NEN	DHJET	TOTAL
ANK. TEK.	84	121	101	116	122	122	132	143	125	135	144	139	1.484
ANK. KOM.	40	53	69	45	89	70	84	95	75	62	77	73	832
TOTAL	124	174	170	161	211	192	216	238	200	187	221	212	2.316

Koment:

Të gjitha ankesat janë shqyrtuar me kohë. Konsumatorët kanë marrë përgjigje zyrtare nga kompania.

Një numër i konsideruar i ankesave është konstatuar se kanë qenë të babazuara.

Raport i faljeve te borxheve- Janar-Dhjetor 2016

Njesia	NrKonsumatoreve	NrKontratave	ShumaKontraktuar	ShumaInkasuar	ShumaFalur
DRAGASH	127	133	25,100.76	11,771.95	39,730.29
MALISHEV	133	141	43,884.91	3,528.41	14,541.00
PRIZREN	4289	4404	917,614.03	215,585.53	1,163,385.33
SUHAREK	618	685	166,700.47	23,616.54	52,255.62
Total	5,167	5,363	1,153,300.17	254,502.43	1,269,912.24

3.2.4 RAPORTI I MEDIAVE

Një nga qëllimet kryesore të KRU-“Hidroregjioni Jugor”, (përveç furnizimit me ujë dhe inkasimit, mirëmbajtjes së rrjetit, etj.) është edhe që ta informojë opinionin publik, gjegjësisht konsumatorin për të gjitha ngjarjet që ndodhin në Kompani, apo për problemet dhe sfidat me të cilat ballafaqohet Kompania, gjithashtu t`a informojë konsumatorin me kohë, shpejtë dhe saktë për pengesat, ndërprerjet në furnizim apo defekte të ndryshme.

Për t`u realizuar këto qëllime sa më mirë, funksionon zyra për informim dhe zëdhënësi.

Detyrat kryesore të këtyre dy mekanizmave janë që të mblidhen të gjitha informatat në kuadër të kompanisë, gjegjësisht nga shërbimet përkatëse dhe ato të përpunohen dhe të plasohen në opinionin publik, në mënyrën më të përshtatshme dhe të kuptueshme për opinionin.

Pra, të gjitha informatat që vijnë nga shërbimet e ndryshme, e që janë me interes për konsumatorin, përpunohen dhe përcillen në të gjitha mjetet e informimit.

Në këtë drejtim kemi marrëveshje dhe bashkëpunim të mirë me të gjitha televizionet dhe radiot lokale, gjithashtu nuk mungojnë edhe kontaktet me televizionet qendrore, poashtu edhe me shtypin ditor.

Qëllimi i këtij raporti është nxjerrja në pah e aktiviteteve vjetore të Kompanisë, që kanë të bëjnë me përcjelljen e porosive në opinionin publik.

Zyra për marrëdhënie me publikun, është munduar që nga fillimi i vitit 2016, që përcjelljen e porosisë që del nga KRU-“Hidroregjioni Jugor” sh.a., përmes mediave elektronike dhe të shkruara, ta bartë te opinionin publik, në mënyrë sa më të shpejtë dhe sa më të ndershme, njëkohësisht duke mbrojtur interesat e Kompanisë në përgjithësi dhe konsumatorit në veçanti.

Mediat lokale, i kanë kushtuar hapësirë të mjaftueshme KRU-“Hidroregjioni Jugor” sh.a. Kanë dhënë kontribut të madh në mënyrë indirekte dhe direkte në ngritjen e shkallës së arkëtimit, në vetëdijësimin e qytetarëve, se uji që shpenzohet duhet kursyer dhe duhet paguar, në informimin e qytetarëve se ujësjellësi i Prizrenit është duke punuar në atë drejtim që t`i përmirësojë shërbimet e veta ndaj çdo konsumatori, se kjo kompani me përkushtimin e saj më të madh, ka arritur që të përfitojë donacione të mëdha nga investitorët e huaj dhe Qeveria e Kosovës, vetëm e vetëm që konsumatorëve të saj t`u ofrojë shërbime sa më cilësore.

Edhe mediat e shkruara kanë dhënë kontribut të mjaftueshëm në shpërndarjen e informacioneve te opinionin publik, lidhur me të gjitha aktivitetet e ndërmarra nga KRU-“Hidroregjioni Jugor” sh.a. dhe se hapësira e tyre dhënë kompanisë ka qenë e mjaftueshme.

RAPORT PËR MEDIA

MUAJI: JANAR – DHJETOR 2016

Nr.	PËRSHKRIMI	MEDIAT	NUMRI TOTAL
1	<u>NJOFTIME</u> TV RADIO SHTYPI DITOR	TV-OPINION TV-BESA TV-PRIZRENI RADIO HELIX RADIO OMEGA KOSOVA SOT KOHA DITORE	48
2	<u>INTERVISTA</u> TV RADIO	RTK TV-OPINION TV-BESA TV-PRIZRENI TRT 1	11
3	<u>EMISIONE</u> TV RADIO	TV-OPINION TV-BESA TV-PRIZRENI RADIO KOSOVA RADIO HELIX	9
4	<u>DEBAT PUBLIK LIDHUR ME PROJEKTIN PËR NDËRTIMIN E IMPIANTIT PËR TRAJTMIN E UJËRAVE TË ZEZA NË PRIZREN</u>	KOSOVA SOT	1
5	<u>KONKURSET</u> <u>ANULIM I KONKURSIT</u>	KOSOVA SOT EPOKA E RE	25 1
6	<u>ARTIKUJT-SHTYPI DITOR</u>	KOHA DITORE KOSOVA SOT EPOKA E RE ZËRI	34
7	<u>ARTIKUJT- SHTYPI ELEKTRONIK</u>	www.tv-opinion.com www.prizreni.tv www.rtvbesa.com www.indeksonline.net www.ekonomiaonline.com www.lajmi.net www.kosovasot.info www.prizrenpres.com www.rtklive.com	160

		www.kosovapress.com www.koha.net www.gazetaexpress.com www.zëri.info www.rtv21.tv www.malishevapress.com www.mediapress.com www.balkanplus.net www.telegrafi.com www.info-ks.net www.rtvbesa.facebook.com www.tv-prizreni.facebook.com www.tv-opinion.facebook.com	
8	<u>KONFERENCË PËR MEDIA</u>	TV-OPINION TV-BESA TV-PRIZRENI	1
9	<u>PREZANTIM NË SHKOLLËN “ABDYL FRASHËRI”</u>	TV-OPINION www.tv-opinion.com	1
10	<u>LIGJËRATË E MBAJTUR NË SHKOLLËN “ABDYL FRASHËRI” ME TEMËN “UJI DHE PUNA”</u>	TV-OPINION www.tv-opinion.com	1
11	<u>NËNSHKRIMI I MARRËVESHJES PËR ZONAT RURALE</u>	TV-OPINION TV-BESA TV-PRIZRENI	1
12	<u>AKTIVITET PËR VETËDIJËSIMIN E NXËNËSVE PËR KURSIMITIN E UJIT, NË SHKOLLËN E MESME TË ULTË “FADIL HISARI” NË PRIZREN</u>	TV-OPINION www.tv-opinion.com	1

KONKLuzion

KRU-“Hidroregjioni Jugor” Sh.A. Prizren, gjatë vitit 2016, ka dërguar 48 njoftime në mediat elektronike dhe të shkruara, lidhur me të gjitha aktivitetet që i ka ndërmarrë kjo kompani.

Disa nga njoftimet janë emetuar në televizione, e disa janë publikuar si shkrime në shtypin ditor, duke dhënë çdo herë një mesazh për opinionin publik.

Mediat janë për t`u lavdëruar në shpërndarjen e informacioneve të opinionit publik, lidhur me të gjitha aktivitetet e ndërmarra nga KRU-“Hidroregjioni Jugor” dhe hapësira e tyre dhënë kompanisë ka qenë e mjaftueshme.

Mbulueshmëria mediale për KRU- “Hidroregjioni Jugor”, për vitin 2016 ka qenë e kënaqshme dhe e mjaftueshme.

Mediat elektronike dhe të shkruara kanë kontribuar edhe në ngritjen e shkallës së arkëtimit në KRU- Hidroregjioni Jugor, duke plasuar informacione të shumta në publik.

3.3.1 AKTIVITETET E DEPARTAMENTIT ADMINISTRATIV

Departamenti Administrativ është një nga Departamentet që ka lidhshmëri të drjtëpërdrejt me Kryeshefin Ekzekutiv. Në kuadër të Departamentit Administrativ sipas strukture organizative të Kompanisë, bëjnë pjesë këto sektorë : sektori i administratës së përgjithshme dhe resursëve njerëzore, zyra ligjore, IT, zyrtari për sigurinë dhe shëndetin në punë, mirëmbajtja dhe pastrimi i objekteve.

Aktivitetet e përbashkëta të punës në Departamentin administratës:

Varësisht nga detyrat dhe obligimet e punës të parapara për këtë departament, departamenti i administratës mirret me përgaditjen e raportëve dhe informatave nga veprimtaria e shërbimit juridik.

- Gjatë këtij viti janë përgaditur të gjitha procesverbalet dhe vendimet e dalura nga Bordi i Drejtorëve, Komisioni i Auditimit, komiteti i financave, komiteti për staf dhe shpërblime dhe Kryeshefi Ekzekutiv i KRU "Hidroregjioni Jugor" sh.a Prizren .
- Pas përgaditjes së Procesverbaleve të Bordit, Komisionit të Auditimit dhe të komiteteve janë njoftuar të gjitha shërbimet (udhëheqësit) lidhur me konkluzionet apo raportet e kërkuara nga mbledhjet në fjalë.
- Është mbajtur procesverbal nga minutat takimit në mes të përfaqësuesve të ARRU dhe KRU "Hidroregjioni Jugor" sh.a Prizren
- Është përgaditur vendim me të cilin është miratur Aneks Statuti për ndërrimin e emrave të anëtarëve të Bordit në Statut dhe në Qertifikatën e regjistrimit të Kompanisë
- Me autorizim të KE janë përgaditur Vendime për mbikqyrje të punimeve dhe pranim teknik të punimeve për projektet e investuara me mjetet vetanake të Kompanisë dhe nga buxheti i Komunave të njesive punuese sipas kërkesës së shërbimit teknik.
- Pas aprovimit nga Komisioni i Auditimit dhe Bordi Drejtorëve, me autorizim të KE është përgaditur vendim për formimin e komisionit i cili do të bëjë përzgjedhjen e punëtorëve të dalluar për vitin 2016 të cilët do të shpërblehen sipas vëllimit dhe cilësisë së punëve të kryera.
- Pas zhvillimit të procedurave sipas rregullores së Kompanisë, janë shpërblyer për angazhim të veçant në punë, 11 (njëdhjetë) punëtorët e dalluar për vitin 2016 me mjete monetare në vlerë prej 100 € dhe me mirënjohje.
- Janë përgatitur dhe vazhduar kontratat e punës për vitin 2016, për të gjithë punëtorët e Kompanisë. Kohëzgjatja e kontratave është bërë duke u bazuar në Raportin e vlerësimit vjetor të punës nga Mbikëqyrësit e drejtpërdrejtë të secilit punonjës. Kontratat e Punës janë vazhduar për kohë të caktuar dhe për kohë të pacaktuar, kjo duke u bazuar në raportin e vlerësimit vjetor të punës nga Mbikëqyrësit e drejtpërdrejtë të secilit punonjës.
- Shërbimi juridik ka përgatitur kontratat në mes të kompanisë dhe palëve të treta nga lamia e veprimtarisë së Kompanisë.
- Sipas kërkesave nga udhëheqësit e njesive punuese Prizren, Suharekë dhe Malishevë dhe pas aprovimit nga Zyrtar Kryesor Financiar ("ZKF") dhe Kryeshefi Ekzekutiv gjatë vitit 2016 janë punësuar **18 (tetembedhjetë)** punëtor me kontrat për punë dhe detyra specifike.
- Sipas kërkesave të udhëheqësve të njesive punuese Prizren, Suharekë dhe Malishevë dhe aprovimit nga Zyrtar Kryesor Financiar ("ZKF") dhe Kryeshefi Ekzekutiv në shtypin ditor janë shpallur **25 (njëzetepesë)** konkurse. Prej këtyre konkurseve një është anuluar, i pozitës së punës - **3 (tre)** punëtor fizik në mirëmbajtjen e sistemit të kanalizimit, shpallur me datë 30.11.2016.
- Gjatë vitit 2016 kanë kryer punë praktike 5 (pesë) praktikant me pages për tre muaj, dhe nëntë praktikant pa pages mujore.
- Gjatë vitit 2016 ka pasur ngritje të koeficientëve sipas kërkesave të udhëheqësve të njesive punuese Prizren, Suharekë dhe Malishevë dhe pas aprovimit nga Zyrtar Kryesor Financiar ("ZKF") dhe Kryeshefi Ekzekutiv i KRU "Hidroregjionit Jugor".
- Me Vendim janë formuar Komisionet për regjistrim vjetor 2016 që përfshin: Komisioni për regjistrimin e mjeteve themelore, veglave të rënda dhe inventarit të imët; Komisioni për regjistrimin e lëndëve të para dhe materialit në depon kryesore dhe në servis të bashkëpunimit; Komisioni për regjistrimin e

arkës, portoarkën, kërkuesit dhe blerësit dhe Komisionin Qendror të regjistrimit. Të gjithë komisionet e regjistrimit do të kryejnë regjistrimin prej 29.12.2016 gjërë më 15.01.2017 dhe në fund do të kryhet barazimi me gjendjen e kontabilitetit dhe raporti do të i dorëzohet komisionit qendror. Komisioni qendror është i obliguar të përpiloj raport mbi kryerjen e të njejtës dhe t'ia dorëzoj Kryeshefit Ekzekutiv gjërë më 20.01.2017.

- Mbështetur në rregulloren e brendshme të Kompanisë “Rregullore mbi orarin e punes te punonjesve” Neni 22 paragrafi 3, punëtori i njesis punuese të Prizrenit Shefqet Xhemali - Ndihmës në shërbimin e inkasimit nga data 09.08.2016 deri me 08.02.2017 dhe punëtorja Atije Sopjani - Referent/e për marrëdhënje me konsumator e njesis punuese Suhareke nga data 16.12.2016 deri me 15.01.2017 janë në pushim mjeksore me pages 70% pagës bazë.
- Janë bërë ndërrime në pozitat e vendëve të punës me pelqimin e punëdhënësit dhe punëmarrësit varësisht nga dinamika e punës dhe nevojat e domosdoshme të Kompanisë.
- I është raportuar NJPMNP nga ZLR që kemi pasur kërkesë për qasje në dokumentet publike për periudhën janar-dhjetor 2016 nga profil i aplikuesve individë për qasje në dokumentet e aplikantëve të konkursit operator në shërbimin me konsumator dhe kërkesa e tjetër ka qenë nga Instituti GAP për qasje në hartën e vendbanimeve të cilat mbulohe në rrjet nga KRU”Hidroregjioni Jugor”. Kërkesat e pranuar janë trajtuar në përputhje me Ligjin Nr.03/L-215 për qasje në dokumente publike.
- Mbështetur në Procedura për Mbikqyrje dhe Monitorim e NP Qendrore pika nent(9), është njoftuar me kohë Bordi i Drejtorëve dhe NJPMNP për mungesën e Kryeshefit Ekzekutiv në punë (pushim vjetor) nga dt.15.12.2016 deri me 04.01.2017.
- ARRU ndryshon licencën e shërbimit Nr.377/DL&L e datës 31.05.2016, amandamentohet pika 4, zona e shërbimit; nga Komuna e Prizrenit largohet fshati Lugishtë(Lubishdë) e Hasit sipas aplikacionit të paraqitur për licencim nr.prot.377/2 e datës 08.09.2016. Ky ndryshim ka hyrë në fuqi me 19.12.2016.
- Poashtu është njoftuar me kohë punonjësi i Lubishtës së Hasit që kontrata e punës ka qenë në kohë të caktuar prej 01.01.2016 deri me 31.12.2016. Pas skadimit të kohëzgjatjes së kontratës së punës e njejtë nuk do të vazhdohet. Shkakë i mos vazhdimit të kontratës së punës është se nga data 28.09.2016 është lidhë marrëveshje mirëkuptimi për menaxhim të përkohshëm për furnizim me ujë të pijes dhe mirëmbajtje të rrjetit të ujësjellësit të Fshatit Lubizhd e Hasit nga KRU”Radoniqi”Sh.A, Gjakovë.
- Pas aprovimit nga komisioni i Auditimit me vendim të KE, për nderë të festës së 28 Nëntorit , Bordi i Drejtorëve dhe të gjithë punëtorët e Kompanis Rajonale të Ujësjellësit ”Hidroregjioni Jugor”Sh.A , janë shpërblyer me nga 50 Euro dhe për për nderë të festës së Vitit të Ri 2017 ne vlerë prej 30€ .
- Duke u bazuar në nevojën e mirëmbajtjes së sistemit të kanalizimit është formuar me vendim ekip i veçant për mirëmbajtjen dhe analizen e sistemit ekzistues të kanalizimit-Ujërave të zeza në qytetin e Prizrenit. Kjo ekipë do të operojë përmes Departamentit Teknik dhe të njejtit do ti raportojë së paku në baza javore.
- Në bazë të nenit 7.pika 2. Statutit të K.R.U”Hidroregjioni jugor”Sh.A me seli në Prizren, janë përpiluar dhe aprovuar dy rregullore të Kompanisë:
 - a. Rregulloren për mbrojtje nga zjarri”dhe
 - b. Rregulloren për udhëtimet zyrtare” në K.R.U. Hidroregjioni Jugor”sh.a, në Prizren
- Janë përgaditur kërkesa me të cilat i jemi drejtuar Kuvendit Komunal në Prizren, për shpallje interes publik dhe marrje në shfrytëzim nga HRJ të ngastrave kadastrale P-71813015-01952-0- Zona Kadastrale Gënçare; P-71813015-01953-0- Zona Kadastrale Gënçare; P-71813015-01954-0- Zona Kadastrale Gënçare dhe të ngastrës kadastrale P-71813068-07117-0- Zona Kadastrale Prizren.
- Janë siguruar dokumentet e nevojshme në lidhje me pranimet rreth punësimeve në KRU”Hidroregjioni Jugor”për periudhën kohore 2011-2012, sipas kërkesës së Sektorit të Hetimeve të krimeve të renda-Prishtinë. Dokumentet e dorëzuara përfshinë ; përgjigjie në kërkesë, dokumentacionin rreth punësimit përfshirë konkursin në atë perudhë kohore; pozitat përkatëse të secilit zyrtarë në Kompani; organogramin e Kompanisë; Emrat e Drejtorëve të Bordit dhe listen e të punësuarve në Kompani në peruidhën kohore 2011-2012.
- Sipas Ligjit për Veteranët e Luftës së UÇK-së dhe Ligjit për drejtat e ish të denuarve dhe të përdjekurve politikë është bërë rregullimi i përvojës së punës për punëtorët që kanë qenë ish të burgosur politik dhe për veteran e luftes së UÇK-së. Punonjësit e Kompanisë me statut të Veteranit luftëtar të UÇK-së dhe punonjësit që kanë qenë të burgosur dhe të denuar politikë për kohën e kaluar në luftë dhe në burg ju njihet e drejta e Stazhit të dyfishtë të punës.
- Është përgatitur Libri lidhës për Qeverisjen Korporative për vitin 2015 dhe dorëzuar në NJPMNP, përmbajtja e saj përfshinë : Certifikatën e regjistrimit të Biznesit, Vendimin mbi emërimin e Bordit,

procesverbalet e mbledhjeve të Bordit për vitin 2015, Vendimet e Bordit për 2015, Procesverbalet e Komisionit të Auditimit, Deklarata e politikës së kompensimit, Vendimet mbi themelimin e komiteteve tjera të Bordit, Procesverbalet e komiteteve, Plan-Biznesi 2015-2017 dhe raporti vjetor 2015.

- Sipas kërkesës së NJPMNP është plotësuar dhe dërguar në Njësi lista e pagave vjetore të Zyrtarëve të lartë në Dhjetor 2016.
- Përgaditja e Aktvendimeve për pushim pa pagesë për disa punëtor të Kompanisë pas aprovimit të kërkesës së tyre nga udhëheqësi i shërbimit përkatës.
- Përgaditja e Aktvendimeve për disa punëtor lidhur me kompenzimin e punës jashtë orarit me ditë pushimi sipas Ligjit të Punës.
- Gjithashtu ky shërbim lëshon për të punësuarit të gjitha llojet e aktvendimeve, autorizimeve dhe vërtetimeve nga fusha e marëdhënieve të punës.
- Në MZHE është dërguar kërkesë lidhur me sqarimet se kush do ti mbuloj shpenzimet e ujit për Objektet e Kultit, gjithashtu e kemi dërguar edhe një Kërkesë për sqarime lidhur me Vendimin e BD për pagesën sipas mbulueshmërisë operative të Njësive Punuese, si dhe një kërkesë lidhur me zgjidhjen e problemit për qiranë e objektit të administratës së Kompanisë.
- Me datë 28.09.2016 është lidhur kontratë Qiradhënje në mes të KRU"Radoniqi"sh.a Gjakovë dhe KRU"Hidroregjioni Jugor".Objekt I kontratës është shrytëzimi I përkohshëm dhe I pjesëshem I palujtshmërisë në objektin administrativë në Ortakoll.Shfrytëzimi I objektit me qira nga ana e KRU"Hidroregjioni Jugor fillon nga 31.10.2016 deri me 30.09.2019 me mundësi vazhdimi deri në marrëveshjen e re kontraktuale në mes të palëve në kontratë,
- Sipas kërkesës së NJPMNP është plotësuar dhe dërguar në Njësi lista (tabela) për shpenzimet e bëra me rastin e vizitës studimore të impiantit të ujërave të zeza në qytetet Korçë dhe Pogradec të Shqipërisë.
- Shërbimi juridik ka përgatitur Kontratat në mes të Kompanisë dhe palëve të treta nga lëmia e veprimtarisë së Kompanisë.
- Është ndryshuar Manuali mbi Orarin e Punës së Kompanisë dhe në vend të tij është nxjerrë Rregullore për Orarin e Punës të Punonjësve të Kompanisë.
- Kanë bërë punë praktike profesionale student të Universitetit të Prizrenit në fushën e Kontabilitetit dhe financave. Puna praktike profesionale është zhvilluar në mbikëqyrje të udhëheqësit nga shërbimit përkatës.

3.3.2 PERSONELI – 2016

Muajt	Nr.i te punsuarve sipas muajve	Vende te plotësuar	Te larguar	Të pensionuar	Punë praktike
Janar	308	3			2
Shkurt	311	3			3
Mars	315	4	1	1	2
Prill	316	1	1		2
Maj	317	1	1	1	
Qershor	318	1			2
Korrik	319	1		1	
Gusht	317			1	
Shtator	317			2	
Tetor	315			1	
Nentor	315	2	2		
Dhjetor	319	4			

3.3.3 KUALIFIKIMI I PUNËTORËVE - GJENDJA: DHJETOR 2016

K.R.U „HIDROREGJIONI JUGOR" SH.A								
KUALIFIKIMI								
DHJETOR	Fakultet	Bachelor	Sk.K. e lartë	Sh. e mesme	Sh.N.E	Shkolla fillore	Pa kualifikim	Gjithsejë
Nr. i punetoreve	33	30	1	202	1	50	2	319
Kualifikimi në %	10.34	9.40	0.31	63.32	0.31	15.67	0.63	

3.3.4 NUMRI I PUNËTORËVE SIPAS NACIONALITETEVE - GJENDJA: DHJETOR- 2016

K.R.U „HIDROREGJIONI JUGOR" SH.A					
Nacionaliteti	Shqiptarë	Boshnjak dhe Musliman	Romë, Ashkali dhe Egjiptas	Turq	Gjithsejtë numri i punëtorëve
Numri i Punëtorëve	266	36	6	11	319
Numri i Punëtorëve në %	83.4	11.3	1.9	3.4	

NUMRI I PUNËTORËVE NË 1000 KONSUMATORË DHE SIPAS GJINISË

GJINIA:	NR	NR. %	Nr. Në 1000 Kon.
FEMRA:	41	12.85	
MESHKUJ:	278	87.15	
TOTAL	319	100.00	

Raport i numrit te punetoreve Janar - Dhjetor, 2016

Nr.	Muaji	Hidroregjioni Jugor	Prizren				Suharekë	Dragash	Malishevë
			Prizren	Bordi	Prakt.	Total			
1	Janar	316	220	6	2	228	37	19	32
2	Shkurt	320	223	6	3	232	37	19	32
3	Mars	323	227	6	2	235	37	19	32
4	Prill	324	230	6	2	238	38	16	32
5	Maj	323	231	6		237	37	16	33
6	Qershor	326	231	6	2	239	38	16	33
7	Korrik	325	231	6		237	38	16	34
8	Gusht	323	229	6		235	38	16	34
9	Shtator	323	230	6		236	37	16	34
10	Tetor	321	227	6		233	37	16	35
11	Nentor	321	229	6		235	36	16	34
12	Dhjetor	325	231	6		237	37	16	35

Me qëllim të përmbushjes së obligimeve ndaj konsumatorëve, respektivisht mirëmbajtjes së rrjetit kompania ka paraparë që të rrisë numrin e punëtorëve gjatë vitit 2016 varësisht nga numri i fshatrave që do të merren në menaxhim.

Rritja e planifikuar e numrit të personelit është bërë edhe duke u bazuar në planifikimet e udhëheqësve të njësive operative të Prizrenit ,Suharekës,Malishevës dhe Dragashit.

Arsyeshmeria tjetër e rritjes së numrit të punëtorëve të planifikuar në plan-biznes 2016-2018 është se parashihet një menaxhim dhe një mbikëqyrje e punimeve në nivel profesional në zona të reja të shërbimit.

Gjatë planifikimit të vendeve të punës, është marrë parasysh Ligji i Punës., Ligji i Ndërmarrjeve Publike dhe Kodi i Etikës.

3.3.5 RAPORTI VJETOR NGA ZYRA LIGJORE E KOMPANISË

PUNËT E KRYERA ME GJYKATAT

	Seanca përgatitore	Seanca kryesore	Seanca të shtyra	Ardhjet nga Gjykatat	Ankesa për Gjykatën e Apelit	Përgjigjet në Ankesa për Gjykatën e Apelit	Aprovimi i Ankesave	Refuzimet e Ankesave	Vërejtje
Janar	/	1	/	29	/	/	/	/	/
Shkurt	1	1	/	7	/	/	/	/	/
Mars	1	2	/	116	1	1	2	/	/
Prill	2	3	1	20	/	/	/	1	/
Maj	1	/	2	23	2	2	/	/	/
Qershor	1	1	1	18	1	1	/	/	/
Korrik	/	2	3	20	1	1	1	/	/
Gusht	/	/	2	23	1	1	/	/	/
Shtator	/	2	2	18	/	/	/	/	/
Tetor	/	6	/	13	1	1	/	1	/
Nëntor	2	3	2	7	1	1	/	2	/
Dhjetor	1	4	2	10	2	2	/	1	/
Totali	9	25	15	304	10	10	3	5	/

PUNËT E KRYERA ME GJYKATAT PËR PERIUHDHËN KOHORE JANAR – DHJETOR 2016

- Janë mbajtur:
- 9 (nëntë) seanca përgatitore;
- 25 (njëzet e pesë) seanca kryesore;
- 15 (pesëmbëdhjetë) seanca gjyqësore janë shtyrë;
- Nga Gjykatat për periudhën kohore Janar – Dhjetor në Kompani kanë ardhur 304 (treqindtë e katër shkresa);
- 10 (dhjetë) Ankesa i janë parashtruar Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë;
- 3 Ankesa nga Gjykata e Apelit të Kosovës në Prishtinë janë aprovuar në favor të Konsumatorëve;
- 5 (pesë) Ankesa të Konsumatorëve Gjykata e Apelit të Kosovës në Prishtinë i ka refuzuar;
- Në vitin 2016 nga Gjykatat Themelore janë sjellë një qindtë tridhjetë e shtatë **(137) Aktvendime** sipas të cilave përfundon Procedura Përmbartimore e caktuar me Përmbartim të kësaj Gjykate për shkak të Ligjit Nr. 05/L – 043 për Faljen e Borxheve Publike.
- Për **40 (katër dhjetë)** lëndë nga gjykatat janë marrë **Vendime** në favor të Kompanisë sonë.

- Për 4 (katër) lëndë si pasojë e vdekjes së konsumatorëve **Konsumatori** Gjykata ka marrë Vendim sipas të cilit këto çështje pushohen.
- Kundër Kompanisë është ushtruar 1 (një) Padi;
- 3 (tre) Konsumatorë janë dënuar me dënim me kusht dhe me shuma në para si pasojë e lypjeve ilegale;

VENDIMET E KOMPANISË NË ANKESAT DHE KËRKESAT E KONSUMATORËVE

Gjatë gjashtëmujorit të parë të këtij viti nga Kompania janë lëshuar gjithsej **234 (dyqindtë e tridhjetë e katër)** Vendime të cilat kanë të bëjnë me përgjigjet e dhëna në kërkesat dhe ankesat e konsumatorëve.

Muaji	Sasia e Vendimeve të lëshuara	Vërejtje
Janar	42	
Shkurt	49	
Mars	22	
Prill	43	
Maj	25	
Qershor	53	
Totali	234	

PUNËT E KRYERA ME PËRMBARUESIT PRIVAT PËR PERIUdhËN KOHORE JANAR – DHJETOR 2016

	Propozi me për përmba përmba rim	Prapësi me nga konsum atorët	Përgjigji e në prapësi me të konsum atorëve	Marrëveshje për pagesën e borxhit
Maj	36	2	2	1
Qershor	23	/	/	6
Korrik	22	2	2	1
Gusht	29	1	1	/
Shtator	41	4	4	5
Tetor	62	4	4	7
Nëntor	69	6	6	9
Dhjetor	139	14	14	25
Totali	421	33	33	54

- Në tabelë janë paraqitur punët të cilat janë kryer me Përmbaruesin Privat, ku siç shihet në total i kemi dërguar **421 (Katër qindtë e njëzet e një) lëndë** me propozim për përmbarim.
- Janë parashtruar **33 (tridhjetë e tri)** Prapësime nga Konsumatorët;
- Kemi dhënë **33 (tridhjetë e tri)** Përgjigje në Prapësime.
- **54 (Pesëdhjetë e katër)** konsumatorë kanë lidhur marrëveshje me Kompaninë për pagesën e borxhit të propozuar për përmbarim.

Punët tjera nga Zyra Ligjore

Konsultimin, analizimin dhe studimin e Ligeve, Udhëzimeve Administrative, Rregulloreve dhe materialeve tjera lidhur me përgatitjet teorike për nxjerrjen e Rregulloreve të ardhshme të cilat duhet të harmonizohen me Ligjet dhe Aktet tjera të reja;

Është dhënë kontribut në harmonizimin e 5 (pesë) Rregulloreve të ARRU-së lidhur me organizimin dhe udhëheqjen e punëve të Kompanive të Kosovës;

Është punuar në plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores për Orarin e Punës së Kompanisë;

Kemi përgatitur Kërkesa, Ankesa, Deklarata të ndryshme, për institucione të ndryshme;

Kemi dhënë Përgjigje në Ankesa, Përgjigje në Padi, Përgjigje në Kërkesa të punëtorëve, përgjigje ndaj konsumatorëve, përgjigje ndaj institucioneve të ndryshme si dhe personave tjerë fizik për çështje të ndryshme;

Kemi vizituar Institucione të ndryshme ku jeni interesuar për bashkëpunimin ndër institucional në mënyrë që të mënjanohen pengesat eventuale gjatë bashkëpunimit;

Janë bërë përkthime të Konkurseve të Kompanisë nga Gjuha Shqipe në Gjuhën Boshnjake;

Janë përkthyer materialet e Tenderëve të Kompanisë nga Gjuha Shqipe në Gjuhën Boshnjake;

Pjesmarrje në Komisione për pranimin e punëtorëve në punë, Komisionet për regjistrim të inventarit dhe mjeteve Themelore të Kompanisë, Komisionin për harmonizimin dhe përcaktimin e Koeficientëve për punonjësit e Kompanisë, etj.;

Kemi pranuar konsumatorë dhe i kemi udhëzuar dhe njoftuar për procedurën përmbartimore dhe hapat që të njëjtit duhet ti ndërmarrin për pagesën e borxheve që kanë ndaj Kompanisë;

Konkluzioneve të ardhura nga Gjykatat lidhur me kërkesat e tyre për adresat e sakta të konsumatorëve, pastaj lidhur me saktësinë e borxheve të debitorëve në kohë optimale u jemi përgjigjur.

Aktivitete e Zyrtarit për Siguri dhe Shendetin në Punë për Vitin - 2016

Gjatë vitit 2016 është bërë sistemimi dhe kontrollimi i rregullt i aparateve kundër zjarrit në KRU "Hidroregjioni Jugor" si dhe janë servisuar me kohë.

Kontrollimi i gjendjes të hidranteve në KRU "Hidroregjioni Jugor" në Prizren.

(Në "Hidroregjioni Jugor" në Prizren kemi tri hidrante: Në Objektin e administrates në Hidroregjion, Objektet e vjetra dhe tek Mulliri i vjetër.

Nxerrja e listes të rojtarëve në të gjitha njësit për objektet ku bëhet kujdestaria me qëllim për të verifikuar se a e kanë kryer trajnimin kundër zjarrit të gjithë rojtarët.

Përmes firmes kontraktuese "ALFAGERR" në Prizren është bërë servisimin e aparateve kundër zjarrit nepër të gjitha Njësitë: Prizren, Suharekë, Malishevë dhe Dragashë

Sipas dokumentacionit të pranimit kemi gjithësej 68 aparate kunder zjarrit.

Shpërndarja e aparateve kunder zjarrit sipas pranimit për servisim janë.

Njësia Prizren kemi - 39 aparate kundër zjarrit

Njësia Malishevë janë 15 aparate kundër zjarrit.

Njësia Suharekë janë 9 aparate kundër zjarrit.

Njesia Dragash janë 5 aparate kundër zjarrit.

Kontrollimi i të gjitha objekteve të Njesisë punuse Prizren janë vizituar keto objekte:

"40 burimet", Objekti Mulliri i Vjetër, Koagulatori, Stacioni i filtrimit, Stacioni i furnizimit Burimi I, Stacioni i furnizimit Burimi II, Rezervari i Pusnicës, Rezervari i Kalasë, Rezervari i Kurillës, Stacionet dhe nënstacioni Pompave në fshatin Zhur, Rezervaret në Zhur, Rezervuari dhe burimi në fshatin Shkozë, Vërmicë, stacioni i pompimit në fshatin Murademe, stacioni I pompimit në fshatin Dobrusht, Stacioni i Pompave Sozi në F. Nashec, Stacioni i Pompave dhe rezervuari në fshatin Kabashë, fshatin Kushnin, Lubizhd e Hasit, Kojush I dhe Kojush II, në fshatin Mazrek, fshatin Planej.

(Për të gjitha këto inspektime ekziston raporti i punës me gjendjen e tyre ekzistuese)

Kontrollimi i të gjitha objekteve të Njesisë Suharekë janë vizituar keto objekte: Pusi i Atit, objekti me rezervaret në Baqevcë, Kaptazhen në Savrovë, Rezervri në Sematishtë së bashku me stacionin e pompimit dhe kaptazhen, rezervari në Reshtan, rezervari së bashku me objektin në Doberdelan, rezervari dhe stacioni i pompimit në Samadrezhë, rezervari dhe stacioni i pompimit në Studenqan si dhe objektin e HRJ në Suharekë.

(Për të gjitha këto inspektime ekziston raporti i punës me gjendjen e tyre ekzistuese)

Kontrollimi i të gjitha objekteve të Njesisë punuse Malishevë janë vizituar keto objekte: stacioni i pompimit në Banjë, stacioni pompimit Kravasari, Maxharrë, Shkozë, stacioni i pompimit në fsh. Burim, rezervarin dhe stacionin e pompimit në fsh. Gurbardhë, nënstacionin e pompimit Turijakë, Bubel, Damanek dhe Qupev, si dhe Objektin e HRJ në Malishevë.

(Për të gjitha këto inspektime ekziston raporti i punës me gjendjen e tyre ekzistuese)

Kontrollimi i të gjitha objekteve të Njesisë punuse Dragash janë vizituar keto objekte:

Objekti i HRJ në Dragash (Objekt i Administartës), Objektet te Stacioni filtrave (komora mbledhse me rezervuar), Rezervuaret.

(Për të gjitha këto inspektime ekziston raporti i punës me gjendjen e tyre ekzistuse)

Gjatë viti 2016 janë inspektuar punëtorët e K.R.U. "Hidroregjioni Jugor" njesia e Prizrenit ku kanë realizuar punime në të gjitha vendet, me qëllim për të verifikuar respektimin e masave të mbrojtjes në punë dhe është vërtetuar se nuk i kanë pasur të mbajtur Helmeta mbrojtëse në kokë. (Për mos respektimin e masave mbrojtjes në punë janë të njoftuar përgjegjësit me shkresë ku edhe ka pasur nderhyrje nga menaxhmenti duke i paisur me helmeta dhe me uniforma të punës).

Takim me kordinatorin e Komunes së Prizrenit për siguri lidhur me sigurinë e objekteve dhe detyrat dhe përgjegjësit e rojtarëve, takimi kishte karakter informues rrethë funksionimit të kësaj shtylle.

Gjatë kësaj periudhe është dërguar kërkesë të gjithë menaxherëve të Njësive dhe menaxherit teknik për të bërë të gjitha paramasat lidhur me nevojat e investimeve në objektet e "Hidroregjionit", të bazuar në raportin e Zyrtarit për Siguri mbi gjendjen e tyre ekzistuse.

Janë përpiluar Draft-dokument me propozim për formimin e Sherbimit për Siguri dhe Emergjencë me detyrat dhe përgjegjësit e menaxherit për Siguri dhe Emergjencë, kërkesa është drejtuar Kryeshefit Ekzekutiv dhe U.D. Sekretarit të Kompanisë

(kjo kërkesë për formimin e shërbimit të veçantë për siguri nuk ka gjetur mbështetje).

Pranimi i aktvendimit nga Inspektoriat i Komunës për ndryshimin e zvoqlimit të madhësisë së reklamës me llogon dhe emrin e kompanisë që qëndret tek objektet e veçtra mbi objektin e "Hidroregjionit Jugor" në rrugën "Vatra Shqiptare", me arsyetim se i kalon përmasat e madhësisë të lejuar nga qendra historike e Prizrenit.

Punimi i formularit (Procesverbal i Deklaratës) për lëndime në punë i cili duhet të plotësohet për të lënduarin – aksidentuarin gjatë orarit të punës.

Gjatë këtij viti kamë pranuar njoftim nga Menaxheri i njesisë Suharekë për lëndimin në vendin e punës të punëtorit Vahid Jashari, dhe e kam vizituar dhe kam plotësuar raportin e lëndimit në punë në praninë e tij dhe të mbikqyersit .

Njoftim nga U.D të sekretarit të Kompanisë lidhur me kërkesën e Ministrisë për Punë dhe Mirëqenies Sociale për plotsorin e formulareve për inspektim nga lëmia e mbrojtjes, siguria dhe shëndeti në punë sipas ligjit nr.04/L-161, dhe ligjit 04/L-156. këto dokumente janë plotësuar dhe dokumentuar para inspektorëve të ministrisë.

Takim me drejtorin për Siguri dhe Emergjencë pranë Kuvendit Komunal në Prizren lidhurë me planin në situatat emergjente për qytetin e Prizrenit, njëherit jam paisur me Planin Bazik për situatat emergjente në regjionit të Prizrenit.

Takim me komandantin e shërbimit të zjarrfikësve lidhur planet për reagimet në situatat emergjente njëherit jam paisur edhe planin e reagimit të këtij shërbimi për situatat emergjente.

Pas Kontrollimit të objekteve janë vërtetuar se Bombolat e Klorit nuk kanë qenë të sistemuar sipas rregullores, ju kam dërguar kërkesë përmes zyrës të Sekretarit të Kompanisë, udhëheqësit të njësive në Prizren që të merë masa në sigurinë e tyre ku edhe është intervenuar duke i vendosur në vend të sigurt.

Gjatë kësaj kohe është dërguar në zyrën ligjore edhe propozimet për ndryshim të draft rregullorës për Mbrojtjen Kunder Zjarrit, dhe njëherit kjo rregullore është aprovuar nga Bordi Drejtorëve.

Kërkesë drejtuar menaxherëve të njësive të Suharekës, Malishevës, Dragashit, për përshkrimin e detyrave të punës për rojtarëve sipas vendit të rojës me qëllim për të dërguar zyres ligjore për aprovim nga ana e Kryeshefit Ekzekutiv të "Hidroregjionit jugor".

Kontrollimi i objekteve në njësien e Prizrenit, Suharekës, Malishevës dhe Dragashit, lidhur me pastërtinë dhe mirëmbajtjen e objekteve, është vërtetuar se nuk janë në gjendje të kënaqëshme.

Gjatë kësaj periudhe kam parashtruar kërkesa për furnizim me kutia për ndihemen e parë për të gjitha njesitë operuse në K.R.U. "hidroregjioni Jugor", kërkesa është drejtuar menaxherit teknik dhe menaxherëve të njësive punuse, mirëpo deri më tani as një objekt nuk është furnizuar me kutia të ndihmes së parë.

Raport rreth punës së zyrës së teknologjisë informative për 2016

Aktivitetet e punës së përditshme detalisht janë pasqyruar në raportet ditore të cilat plotësohen në fund të orarit të punës. Këto raporte janë të gatshme në çdo kohë të prezentohen para autoriteteve dhe udhëheqësve të Kompanisë.

Janë disa angazhime të përditshme që ekzekutohen konform detyrimeve të vendit të punës për operim dhe funksionimit optimal të sistemit në përgjithësi dhe të cilat nuk evidentohen çdo herë në raporte për shkak të përsëritjes.

Prandaj ky raport shtron kryesisht aktivitetet e përmbledhura duke veçuar ndonjë punë ekzekutuese që ka patur peshe dhe ndikim të veçantë.

Në konsultë me Menaxherin, kam përpiluar një pasqyrë ditore raportuese për evidentim të aktiviteteve të përditshme e cila e njëjta do të shërben për përpilimin e raporteve periodike dhe vjetore..

Raporti

- Asistencë profesionale për funksionimin normal dhe optimal te rrjetit kompjuterik në bazë dhe në njësi të kompanisë.
- Nderhyrje në njësinë e Malishevës (print, server, vpn router, klient) : 90 herë.
- Nderhyrje ne zyren e portoarkes - Komune – Malisheve: 68 here
- Ndërhyrje në njësinë e Therandës (print, server, vpn router, klient) : 118 herë.
- Nderhyrje ne zyren e portoarkes Komune – Therandë: 30 here.
- Ndërhyrje në njësinë e Dragashit (print, server, vpn router, klientë): 55 herë.
- Ndërhyrje në njesitë Shatërvan: 140 herë.
- Ndërhyrje në njesitë Depo: 64 herë.
- Ndërhyrje në njesinë Filtrat: 229 herë.
- Ndërhyrje në zyren e protoarkes – Komunë - Prizren: 193 herë.
- Ndërhyrje në Ueb Faqe 15 herë; Njoftime per konsumatore, gjithsejt 10, ngarkim i dokumenteve, gjithsejt 5.
- Ndërhyrje në Bazë (print, server, vpn router, klientë, fotokopje) : 2820 herë.
- Përkujdesje për qasjen e Kompanisë në rrjetin e internetit.
- Përkujdesje për menaxhimin dhe mbarëvajtjen e punës së serverit qendror, programit NAVISION, serverave të Njësive, serverit të GIS sistemit dhe sigurisë së të dhënave.
- Asistencë teknike për funksionimin normal te rrjetit telefonik lokal dhe fiks.
- Planifikim i infrastrukturës së mëtutjeshme në bazë të nevojave dhe kërkesave të Kompanisë.
- Riparim harvderik dhe softverik të paisjeve kompjuterike, programeve aplikative operacionale që shfrytëzohen në Kompani.
- Mbikqyrje rreth zbatimit të kontratave të furnizimeve dhe servisimeve të paisjeve kompjuterike e paisjeve të ngjajshme teknike.
- Përkujdesje për licencimin - vazhdimin e licencimit të programeve operative të kompanisë.

- Përditësim i ueb faqes së Kompanisë.
- Abonimi i ueb faqes dhe domenit hidroregjioni-jugor.com per dy vite deri me 04.03.2018. Pagesa: 137 Euro
- Riparim i fotokopjes se faturave bashke me MIRI Xerox Service.
- Shtrirje e kablllove tek Faturat dhe punetoret e rinje; Betim Koqinaj, Rrezarta Malsori.
- Furnizimi me 5 kompjutere fujitsu/siemens c2d/2GB RAM/ 160 HDD, 1 laptop hp c2d/4gb/2.4ghz/160hdd, 5 monitor 19", 1 monitor 20" nga Computer City – Prizren.

Kompjuteret fujitsu siemens jane shperndare si vijon

- * Majlinda Gashi (plus monitor 19"),
 - * Rexhe Ukaj (plus monitor 19"),
 - * Muhamet Piraj – Dragash (plus monitor 19"),
 - * Adem Morina (pa monitor)
 - * Liridon Fetahaj (plus monitor 19")
- Laptopi hp eshte dorëzuar - Bujar Spahiut
 - Nje monitor 19" te furnizuar nga Computer City, eshte dorezuar Hashim Kryeziut- Zyret e vjetra, ndërsa shtepiza ishte e shfrytëzuar nga Kurtish Krasniqi.
 - Kompjuteri dell ci3/3.1/4gb/250 toëer eshte marre nga Nentor Baraliu (plus monitor 20")
 - Kompjuteret e mbetur nga punetoret qe janë paisur me kompjutere te rinje jane dorëzuar si vijon:
 - * Kompjuteri i Rexhe Ukajt eshte dorëzuar zyres për logjistikë - Kurtish Krasniqit
 - * Kompjuteri i Muhamet Pirajt eshte dorëzuar rojeve – Dragash.
 - * Kompjuteri i Majlinda Gashit eshte dorëzuar zyres se prokurimit - Shatervan
 - * Kompjuteri i Adem Morines eshte dorezuar Urim Bytyqit – Suhareke.
